

**Provimet
eksterne**
Matura me
laps dhe letër

Fq.4



**GJYKATA
E APELIT**
"Kumanova"
peng i
përkthimit

Fq.5



**A kry-
heshka
revolu-
cioni...**

Fq.10



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3375 · E martë, 29 maj 2018

16°C | 27°C

15 DEN



**KOHA për
kulturë**

Fq.12-14

KULTURË

**Revolucioni
i keqkuptuar
nga bijtë e tij**



Përkitazi me premierën 'Vdekja e Dantonit' e autorit gjerman Georg Buchner, në regji të Dino Mustafiqit, realizuar nga Teatri Shqiptar i Shkupit...

Fq.12

RAJON

**Çdo ditë e më
pak shqiptarë**

Fq.15

DOSSIER

**Situata në RS
të Maqedonisë
deri në
shpalljen e
Autonomisë**

Fq.18

GLOBI

**Në botë,
2 miliard
persona
konsumojnë
ujë të ndotur**

Fq.15



NEGOCIATAT NË FAZËN FINALE, MARRËVESHJA MES KRYEMINISTRAVE

EMRI NË DUART E ZAEVIT DHE CIPRASIT



"Sot dhe me siguri nesër, do të vazhdojnë negociatat në nivel të ekspertëve - ajo që duhet të zgjidhet janë çështje teknike - juridike. Menjëherë sapo të përfundojnë edhe ato dhe sapo të sqarohen çështjet teknike dhe juridike, tekstet e përpiluara në nivel të ministrave të punëve të jashtme do t'u dorëzohen të dy kryeministrave, të cilët do të bisedojnë dhe do të arrijnë marrëveshje përfundimtare", tha Koxias

Fq.3

"Vera e Ohrit", një edicion si të tjerët

Shkup, 28 maj - Edicioni i 58-të i festivalit "Vera e Ohrit" këtë vit do të ngjisë në skenë rreth 800 artistë nga 27 vende të botës, emra të njohur të muzikës dhe teatrit. Por në manifestimin me më renome muziko-skenik, numri i artistëve shqiptarë që do të performojnë është shumë i vogël. Teatri Shqiptar i Shkupit dhe interpretues nga Shqipëria (violinisti Elvin Hoxha), janë ndër përfaqësuesit e vetëm në këtë edicion, ku

pritej që të mos mungonin emra të njohur të muzikës të cilët vitin e kaluar ishin planifikuar të merrnin pjesë. Prej disa vitesh, interesimi për prezencën e artistëve shqiptarë që performojnë në botë ka ardhur duke u reduktuar, së bashku me numrin e tyre. Teatri Shqiptar i Shkupit do të prezantohet me "Vdekjen e Dantonit", me regji nga Dino Mustafiq, premiera e së cilës u dha pak ditë...

Fq.7



EDITORIAL

ÇETA E PROFITERËVE LETRAR



Emin AZEMI

Çeta e profiterëve letrar, të cilëve nuk iu del pensioni i magazinierit në Shqipëri, vijjnë dhe fusin tureçkën nëpër "grazhdet" e Kosovës e Maqedonisë dhe dalin prej "stallave" krijuese me autorë të mbaruar taze

Po thonë se në Kosovë e Maqedoni është gjetur ilaçi për tu bërë frikë e frikë shkrimtar. Sidomos ata që kanë mungesë të theksuar talenti, por që kanë shumë dëshirë t'u diel emri nëpër kopertina librash, po angazhojnë me pagesë pensionistë nga Shqipëria (magazinerë, ish ushtarakë, brigadierë, specialist për tufëzim dhish), të cilët dikur kishin patur ëndërr të bëheshin poetë, mirëpo kishin dështuar në këtë tentativë. Ata tani po i kompensojnë pasionet e tyre të rinisë dhe nga qyteti në qytet, nga nahia në nahi, këtu në Maqedoni e Kosovë, po lëvizin si një çetë profiterësh letrar dhe po gjejnë kandidatë për t'u bërë shkrimtar. Këta shkruar me pagesë kanë tarifën e tyre dhe sa më i rëndë shpërblimi, aq më të trasha dalin librat, pa çka se në to nuk ka kurrfarë vlere letrare. Ku pyesin këta mercenarë të skribomanisë për vlera? Për njërin palë (ata që shkruajnë me pagesë) me rëndësi është të zhvatin sa më shumë lekë, për palën tjetër (ata që duan të bëhen shkrimtarë) të bëhen emra të afirmuar brenda natës. Priti pastaj promovimet, njërin pas tjetrit, tekta radhiten poetë të shpifur e autorë të vërtetë, të cilët flasin për të njëjtin libër sikur të ishin dy autorë të ndryshëm. S'ka më katastrofë se të shohësh kinse recensionist tek flet për librin që e ka shkruar vet, kurse kinse poeti (autor i shpifur) shet poza të krijuesit serioz dhe qeras me autogramë gjithë ata që presin në radhë për të marrë librin. Ky i fundit madje merr edhe ndonjë çmim të parë, të cilin e ndan/vlerëson autori me pagesë, sepse vetëm ai ia din "vlerat" broçkullës që ai i thotë poezi.

Na u mbush populli me poet. S'mbet kush pa u bërë autor librash. Ata që s'e kanë fatin të jenë në këtë grup, ngelin përgjithmonë jashtë rrjedhave të letërsisë së tredhur.

Dikur ishte më problem të botosh libër. Madje ishte edhe njëfarë privilegj të jesh në mesin e emrave të nderuar të letrave. Edhe atëherë kishte do korigjime që bëheshin në emër të redaktimeve, mirëpo si dukuri ishte më e izoluar. Edhe atëherë dilnin autorë të shpifur nga "inkubatorët" e shkrimtarëve të afirmuar, por vërehej prej aeroplani jooriginaliteti dhe falsiteti i tyre, ndonëse plot prej indigo/autorëve edhe sot mundohen të shkëpurdhin në plehërishtën e tyre të quajtur "rrethi letrar".

Çeta e profiterëve letrar, të cilëve nuk iu del pensioni i magazinierit në Shqipëri, vijjnë dhe fusin tureçkën nëpër "grazhdet" e Kosovës e Maqedonisë dhe dalin prej "stallave" krijuese me autorë të mbaruar taze. Nuk është me rëndësi se çfarë ere mbajnë produktet e tyre. E rëndësishme është forma, që nganjëherë i ngjason edhe bajgës, dhe mjafton të zë një vend në truallin e etshëm për pleh letrar.

Na u plehërua ambienti krijues nga kjo furtunë botimesh pa kriter. Një Zot e di se kur do të merr fund kjo furtunë, por është e sigurt se si popull do të përfitojmë shumë sepse do të fillojmë të flasim me rimë dhe do të përshëndetemi poetikisht. Poezi dhe vetëm poezi do të rrjedhë në jetën tonë dhe nuk do të mund ta ngremë kryet nga kjo "torishtë" hajvanësh krijues. Të takosh një poet sagllamë sot mund ta quash veten me fat, sepse çeta e profiterëve letrar po punon me të madhe që të imponojë masën e tyre pseudokritike dhe rirreshtimit në hierarkinë e shpifur të vlerave.

PROKURIMI DHE KUSHËRIRI I KOMANDANTIT

"Sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright, më pyeti një herë se si shkonte puna në Kosovë nën protektorat ndërkombëtar dhe në vend të analizës së gjatë mbi kompetencat e ngatërruara, sistemin e ligjeve të Kosovës, Serbisë, Jugosllavisë dhe rregulloreve të UNMIK-ut, që bënin lëmshin që vetëquhej sundim i ligjit dhe çdo gjë tjetër që dukej sikur Kulla e Babelit në të cilën njerëzit e të gjitha gjuhëve të botës nuk mund të merreshin vesh, ia tregova në një rrëfim që tingëllon si anekdota për krizën e një dite të vetme.

Ajo që njëra prej ditëve kur u ndërpre në tërësi prodhimi i energjisë elektrike. Në mbledhjen e mëngjesit të udhëheqjes së vendit - UNMIK-ut, kryeadministratori Kouchner kërkoi menjëherë informatë nga shefi i Shtyllës së Katërt (BE-së, që merrej me ekonomi), Dixon, përse bëhej fjalë. Ai kishte marrë informatë se ndërprerja e energjisë ishte bërë sepse mungonte një kimikat, i cili ishte banal, dhe si i tillë i blerë në furnizim të rregullt, por kur mungonte, siç bënte tash, ishte një kimikat banal që e ndërpret tërë prodhimin e energjisë elektrike. Rrëfimi për kimikatin u elaborua gjerë e gjatë nga teknologët, pastaj nga drejtuesit ekonomikë. Ai nuk u ble, sepse këtë nuk e bëri Prokurimi, dhe këtu pastaj u hap debati për kompetencat e Prokurimit - a i kishte KEK-u apo Shtylla e Katërt e UNMIK-ut, dhe brenda KEK-ut a e kishte kushëriri i këtij apo atij 'komandanti'.

Debatin e ndërpreu në atë moment Kouchneri dhe kërkoi që të gjendet urgjentisht kimikati, për të cilin për herë të parë kishin dëgjuar, por që të gjithë tanimë ia shqiptonin emrin sikur të kishin qenë në Obiliq për më shumë se një mandat...", shkruan në FB, publicisti nga Prishtina, Veton Surroi.

MËNGJESI I FRYTSHËM

"Bashkimi Evropian është e inkurajuar nga raundi i fundit i negociatave mes Shkupit dhe Athinës për kontestin për emrin. Mbledhja e mëngjesit ka qenë e frytshme dhe se të gjithë kanë shprehur përkrahje për procesin e negociatave. Konsensusi është se zgjidhja për emrin do të jetë kthesë për hapat e ardhshme në procesin qasës për Maqedoninë", shkroi në tuitër, Eurokomisari për zgjerim, Johannes Han.

POPULIZMI DHE EUROPA

"Edhe shprehja. Integrimi në Europë apo integrimi euroatlantike kaloi në shprehje populiste. Keni vërejtur politikanë se kurrë s'kanë apo s'dinë çka tu thonë popullit, i fillojnë këto fraza.

Të njëjtit janë të lidhur ngushtë me bizneset e mëdha, të cilët nuk duan hyrje në BE. Këta nuk duan hyrje në BE për shkak të superstrukturës administrative me një kontroll të lart të punës. Lidhja e ngushtë mes biznesit të madh dhe politikanëve.

Apo më mirë thënë politikan rezultat i biznesit të madh pengojnë integrimet në BE, ndërkohë që me frazat, integrim euroatlantik, integrimi europian si metoda populiste mbahen në pushtet", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.

MEDIACitate

KURZ KËRKON NEGOCIATAT PËR SHQIPËRINË

Kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz kërkoi hapjen e shpejtë të negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë. "Kurz kërkoi të menjanojë konfliktet në fqinjësinë tonë në Ballkanin Perëndimor dhe do të kontribuojë për stabilizimin, ai duhet t'u ofrojë një perspektivë të besueshme europiane vendeve në rajon", ka thënë politikan austriak për gazetën gjermane "Welt am Sonntag." Austria mbështet Serbinë dhe Malin e Zi që kanë bërë përparime në pjekurinë për anëtarësim. "Edhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë duhet të fillojmë të hapim negociatat", tha Kurz. Samiti i qershorit do të vendosë, nëse do të hapen negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Në Gjermani, sidomos në partinë konservatore, CDU dhe CSU, por edhe në disa vende të BE-së ka ende rezerva për këtë hap. Por Komisioni Europian e mbështet hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë.

(Welt am Sonntag, 28 maj)

GANASËRISH DOTA SHQYRTOJË NJOHJEN E KOSOVËS

Çështja e statusit të Kosovës do të shqyrtohet sërish në Republikën e Ganasë, ka deklaruar sot kryetarja e Kuvendit të Serbisë Maja Gojković pas takimit me kryetarin e Parlamentit të Ganasë Aron Michael Oquaje. "Bashkëbiseduesi im ka thënë se do të shqyrtohet sërish, në mënyrë të veçantë statusi i Kosovës dhe se Kosova është një çështje e rëndësishme për Ganan", citon RTV të ketë thënë Gojković. Në një konferencë të përbashkët shtypi me Oquaje, Gojković ka folur për negociatën me Kosovën. Mediat serbe spekulojnë se Gana është në hapa të anulimit të njohjes së pavarësisë së Kosovës.

(RTV, 28 maj)

NËSE NUK E KENI DITUR...

ÇFARË DIHET PËR HISTORINË E KANINËS?

Kanina është fshat në rrethin e Vlorës, në shpatin verior të malit të Lungarës. Bën pjesë në fshatin e bashkuar Sherishtë. Gërmimet arkeologjike e dëshmojnë si vendbanim që në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të fundit p.e.s. Në shek.IV p.e.s. u shndërrua në qytet të fortifikuar me mure. Brenda kështjellës së Kaninës janë zbuluar rrënoja banesash, rrugë me kalldrëm, sterra uji etj. E vijoi jetën si

kështjellë dhe qytet mesjetar mbi bazën antike duke u rindërtuar disa herë. Emri i Kaninës përmendet për herë të parë në shek.XI. Për shkak të pozitës së saj strategjike, ajo u gjet shpesh herë e përfshirë në ngjarjet e mëdha luftarake të kohës. Që nga shek.XIII Kanina përmendet si seli e një peshkopate të rëndësishme. Emri i Kaninës deri në shek.XV del gjithmonë i bashkuar me Vlorën.

NEGOCIATAT NË FAZËN FINALE

EMRI NË DUART E ZAEVIT DHE CIPRASIT

"Sot dhe me siguri nesër, do të vazhdojnë negociatat në nivel të ekspertëve - ajo që duhet të zgjidhet janë çështje teknike - juridike. Menjëherë sapo të përfundojnë edhe ato dhe sapo të sqarohen çështjet teknike dhe juridike, tekstet e përpiluara në nivel të ministrave të punëve të jashtme do t'u dorëzohen të dy kryeministrave, të cilët do të bisedojnë dhe do të arrijnë marrëveshje përfundimtare", tha Koxias



ROTH: TË MOS PENGOHET ZGJIDHJA E QETË E KONTESTIT PËR EMRIN

Ministri shtetëror gjerman i Çështjeve Evropiane, Mihael Roth, shfaq mbështetje për procesin negociues midis Shkupit dhe Athinës dhe bëri thirrje për zgjidhje të qetë, pa pengesa. Roth, i cili merr pjesë në Këshillin e djeshëm për punë të jashtme të BE-së, deklaroi: "Sërish u takuam sot me ministrin e Maqedonisë Dimitrov. Jemi mirënjohës për negociatat e përhershme midis



Greqisë dhe IRJM-së. Jemi të gatshëm të japim çfarëdo mbështetje për zgjidhjen e emrit. U bëjmë thirrje të gjithë të mos pengojnë gjetjen e zgjidhjes paqësore. Bëhet fjalë për stabilitet dhe paqe në të gjithë rajonin dhe perspektivë evropiane është vegla më e mirë që parimet tona të merren parasysh. tejkalimi i kontestit për emrin është pikë shumë e rëndësishme, jam optimist për ditët në vijim".

Koha Fatos RUSHITI

Bruksel, 28 maj - Ministrat e Punëve të Jashtme kanë përfunduar pjesën e tyre, negociatat vazhdojnë në nivel të ekspertëve, ndërsa kur do të përfundojnë edhe ato, tekstet e përpiluara nga ministrat do të jenë në duart e kryeministrave për marrëveshje përfundimtare. Kështu ka thënë shefi i diplomacisë greke Nikos Koxias lidhur me negociatat për emrin, sipas të cilit, të dy ministrat e Punëve të Jashtme përfunduan me atë që e ndërmonëm nga kryeministrat e të dyja vendeve.

"Sot dhe me siguri nesër, do të vazhdojnë negociatat në nivel të ekspertëve - ajo që duhet të zgjidhet janë çështje teknike - juridike. Menjëherë sapo të përfundojnë edhe ato dhe sapo të sqarohen çështjet teknike dhe juridike, tekstet e përpiluara në nivel të ministrave të punëve të jashtme do t'u dorëzohen të dy kryeministrave, të cilët do të bisedojnë dhe do të arrijnë marrëveshje përfundimtare", tha Koxias.

Ai dhe Nikolla Dimitrov deri mëbrëmë vonë kanë negociuar dhe kanë arritur kornizë për kompromis për emrin. "Kishim takim produktiv, kemi kornizë që duhet të përpunohet dhe në të për momentin ekupe ligjore prej të dy ministrave në Athinë punojnë, planifikohet bisedë e rëndësishme në nivel kryeministrash, Zaeve me Cipras nga mesi i kësaj jave, ku shpresojmë se do të vendoset për disa punë të rëndësishme nga obSIONET që janë në lojë", deklaroi Dimitrov. "Mendoj se këtë duhet t'ua lëmë kryeministrave. E pamë sa komunikimet rreth procesit ndikojnë ndaj tij, e kemi tashmë këtë përvojë t'i japim mundësi procesit", është shprehur ministri i Jashtëm i Maqedonisë.

Dimitrov pati mëngjes joformal me ministrat e Punëve të ja-

shtme të BE-së apo zëvendësimit të tyre. Franca dhe Holanda kanë qenë më të rrepta në lidhje me fillimin e negociatave, siç pritej. Por, ministri vlerëson se "mrekullitë janë të mundshme".

"Është bukur ta dimë se kjo nuk është e thjeshtë... Konsolidimi i brendshëm në BE është komplementar e jo në kundërshtim me konsolidimin e Ballkanit, ndërsa nëse ndodh ky depërtim historik do të jetë mundësi edhe për mbarë Evropën të krijojë sukses. Nuk jemi në situatë të kemi luks të lëshojmë mundësi historike", deklaroi Dimitrov. Emri i ri, siç raportojnë mediat greke, është mund të jetë i lidhur me termin "Krusheva" (Republika e Maqedonisë së Krushevës), megjithëse propozimi përfundimtar do të jetë për përdorim si të brend-

shëm, ashtu edhe ndërkombëtarë.

Në ndërkohë, edhe përfaqësuesja e lartë e BE-së për Punë të Jashtme dhe Siguri, Federika Moggerini, pas mëngjesit me ministrin Dimitrov, në Bruksel doli me deklaratë për mbështetje të procesit për gjetje të zgjidhjes për emrin. "Të gjithë jemi shumë të inkurajuar nga përparimi mes Shkupit dhe Athinës për emrin, të gjithë do të punojmë të mbështesim dhe shoqërojmë epilog pozitiv", deklaroi Moggerini.

Eurokomisari për zgjerim, Johannes Han ndërkohë në profilin e tij në twitter porositi se BE-ja është e inkurajuar nga raundi i fundit i negociatave mes Shkupit dhe Athinës për kontestimin për emrin. Han, i cili mori pjesë në mëngjesin joformal të organizuar nga Bullgaria dhe Austria, me ministrin Nikolla Dimitrov dhe ministrat evropianë të Punëve të Jashtme në Bruksel, porositi se mbledhja ka qenë "e frytshme" dhe se të gjithë kanë shprehur përkrahje për procesin e negociatave. "Konsensusi është se zgjidhja për emrin do të jetë kthesë për hapat e ardhshme në procesin qasës për Maqedoninë", shkroi në twitter Hani.

Merret vesh se ministri Dimitrov e ka hapur mëngjesin me fjalim hyrës për përparimin e negociatave me Greqinë, ku i ka

TË PREMTEN VOTOHEN MINISTRAT E RINJ

Seanca parlamentare për rikonstrukcion të Qeverisë do të mbahet të premtën më 1 qershor. Në rend dite do të jenë zgjedhja e anëtarëve të Qeverisë, që duhet të përfundojë deri në mesnatë, ndërsa si pikë e dytë është zgjedhja e zëvendësministrave. Zgjedhja e anëtarëve të rinj të Qeverisë përputhet me përvjetorin e formimit të Qeverisë së re të kryeministrit Zoran Zaev. Për ministrat të rinj janë propozuar Renata Deskoska për Drejtësi, Arbër Ademi për Arsim, Asaf Ademi për Kulturë dhe Bardhyl Dauti pa dika-ster. Për zëvendësministrat janë propozuar Andrei Zhernovski, zëvendësministër i Punëve të Jashtme, Asim Musa zëvendësministër e Shëndetësisë, Gonyl Bajraktar zëvendësministër i Punës dhe Politikës Sociale dhe Sadik Beqiri, zëvendësministër i Transportit dhe Lidhjeve. Hollësitë për mbajtjen e seancës janë definuar në takimin e djeshëm të rregullt të kryetarit të Parlamentit, Talat Xhaferi, në të cilën sërish nuk ka marrë pjesë asnjë përfaqësues i VMRO-DPMNE-së opozitare. Paraparakisht, për të enjten në Parlament tashmë është caktuar seanca për pyetje të deputetëve. Aktivitetet tjera në Parlament për këtë javë nuk janë caktuar, nëse nuk merret parasysh takimi i rregullt mujor i kryetarit të Kuvendit Talat Xhaferi me përfaqësues të mediave.

dërguar të njëjtat porosi si dhe ato në opinion: se është arritur kornizë për zgjidhje dhe se grupe të ekspertëve në të dy vendet e shqyrtojnë tekstin në Athinë. "Kur filluam, kemi pasur dallime të konsiderueshme, por siç përparojmë në këtë proces, kam përshtypje se gjithnjë e më tepër jemi në të njëjtën anë", tha Dimitrov. Ministri pastaj u paraqit me një listë të reformave dhe përpjekjeve të cilat i ka bërë Maqedonia në vitet e fundit, nga reformat gjyqësore, luftës kundër korrupsionit, dialogut me opozitën, lirim të sferës mediale, si dhe përmirësimit të marrëdhënies fqinjësore. Ai nga vendet anëtare ka kërkuar t'i ndihmojnë Maqedonisë me atë që do t'i japim fillim të negociatave.

BISEDË TELEFONIKE ZAEV-CIPRAS

Së paku një herë, e ndoshta edhe dy herë, kanë biseduar në telefon kryeministrat e Maqedonisë dhe Greqisë, në periudhën pasi që i kanë njoftuar forcat politike në të dy vendet para një jave, kumtoi televizioni grek "Skaj".

"Temë bisede, ishte implementimi i erga omnes për emër nga pakoja e propozimeve të ndërmjetësit Methju Nimic. Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, gazetari nga televizioni grek komentoi, se "pasi që u fundos Ilindeni, duket sikur në rrjedhë është maratona që të mos humbet mundësia" dhe të mbyllet çështja



deri në Samitin e BE-së në fund të qershorit. "Sipas informatave që i kemi, Aleksis Cipras dhe Zoran Zaev, pasi që të shtunën e kaluar, i njoftuan presidentët dhe liderët e partive politike, kontaktuan me telefon së paku një herë apo dy herë dhe duhet të shtojmë se zyrat diplomatike

të dy kryeministrave janë në kontakt të vazhdueshëm. Në këto biseda telefonike tema ishte erga omnes, përkatësisht cili emër do të mund të zgjedhet nga pakoja e Nimicit dhe të shfrytëzohet si brenda, ashtu edhe jashtë", kumtoi televizioni grek.

Në kuadër të provimeve përfundimtare të shkollimit të mesëm, maturantët do t'ju nënshtrohen edhe këtë vit tre lloj verifikimesh, ndërsa do të marrin katër nota - edhe atë tre nga provimet eksterne dhe një nga detyra projektuese

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 28 maj - Janë caktuar datat për mbajtjen e provimeve të Maturës shtetërore me vlerësim ekstren ose notim të jashtëm, që do të nisnin nga e shtuna e kësaj jave, megjithëse shkollat ka kohë që janë në vllugun e organizimit të provimeve përfundimtare.

Varësisht terminëve të caktuar nga vetë shkollat, në periudhën nga 14 marsi deri më 16 maj, nxënësit e viteve të katërta apo të treta të shkollave të mesme kishin mundësi të prezantojnë detyrat projektuese të lëndëve që ata kishin zgjedhur paraprakisht. Ndërkaq, provimi intern i lëndës në fjalë e që gjithashtu është pjesë e maturës shtetërore do të organizohet në ndonjërin prej datave që kap periudhën nga 15 deri 29 qershori. Për këtë datë do të vendosë Komisioni shkollior i maturës shtetërore, ndërsa notat përkatëse njëjtë sikurse edhe notat e detyrës projektuese nxënësit do ti marrin nga vetë profesorët e lëndës në të cilën janë përcaktuar paraprakisht.

Ndryshon puna me notat e tre provimeve tjera të Maturës shtetë-

CAKTOHEN DATAT E PROVIMEVE EKSTERNE TË MATURËS SHTETËRORE

MATURA ME LAPS DHE LETËR



lohet mësimi, si dhe dy lëndë të tjera zgjedhore.

Për provimin e dytë, maturantët duhet të zgjedhin mes matematikës dhe njëres prej gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe rusisht), të cilën nxënësit e kanë mësuar gjatë katër viteve të shkollimit. Për provimin e tretë do të duhet të zgjedhin mes kimisë, fizikës, biologjisë, historisë, filozofisë, estetikës dhe biznesit. Dhënia e këtyre provimeve është caktuar për datën 11 qershor. Provimet e gjuhës amtare do të mbahen më 9 qershor, përderisa provimet e gjuhës së huaj më 2 qershor dhe të matematikës më 13 qershor.

Ky është viti i 12-të që në Maqedoni organizohen provimet e Maturës shtetërore të cilat kanë zëvendësuar dhënien e provimeve pranuese nëpër fakultete e, që në bazë të përvojës së shumë shteteve evropiane konsiderohen edhe tek ne si provime përfundimtare të cilat certifikojnë mbylljen e ciklit të arsimit të mesëm, i obligueshëm për të gjithë nga viti 2007. Tani për tani Matura shtetërore konsiderohet si një prej proceseve më komplekse dhe më voluminoze, kur përveç 17 mijë maturantëve të këtij viti, do të përfshihen mbi 2 mijë profesorë testatorë, rreth 400 vlerësues, koordinatorë lokal e anëtarë të komisioneve të ankesave. Rezultatet e provimeve eksterne do të kumtohen jo më vonë se 30 ditë nga mbajtja e provimeve.

rore, të cilat do të caktohen nga komisione jashtë shkollës, respektivisht nga Qendra Shtetërore e Provimeve, ku janë formuar edhe ekipet përkatëse. Pikërisht për shkak të vlerësimit jashtë shkollës (notimit ekstern), këto provime llogariten edhe më të vështirë. Të njëjtët janë gjithashtu edhe provime me më tepër peshë, pasi notat në fjalë do të ndikojnë në mesataren e përgjithshme të notave të arsimit të mesëm. Nga kjo mesatare do të varet më tej edhe renditja në listën e kandidatëve për regjistrim në fakultet, ashtu sikurse edhe lëndët që maturantët do të zgjedhin të testojnë njohuritë e tyre në kuadër të provimeve ekstrene të maturës shtetërore. Pra, në kuadër të provimeve përfundimta-

RRITET NUMRI I TË DIPLOMUARVE

Në vitin 2017 në Maqedoni kanë diplomuar gjithsej 8545 studentë në shkollat e larta profesionale dhe fakultetet, që në krahasim me vitin 2016 është rritje për 3.6 për qind, kumtoi Enti Shtetëror për Statistikë. Prej tyre, në institucionet shtetërore të arsimit të lartë kanë diplomuar 6.460, në fakultetet private 2045 dhe në fakultetet fetare 40 studentë. Nga numri i tërësishëm i të diplomuarve, 82.1 për qind janë studentë të rregullt, ndërsa 17.9 për qind janë studentë të çrregullt. Përqindja e studentëve të diplomuar është 57.5 për qind. Në afat kanë diplomuar 38.6 për qind, ndërsa 61.4 për qind kanë diplomuar pas afatit.

re të shkollimit të mesëm, edhe këtë vit maturantët do t'ju nënshtrohen tre lloj verifikimesh, ndërsa do të marrin katër nota edhe atë tre nga provimet ekstren dhe një nga detyra projektuese. Mirëpo do të kenë edhe provime interne në lëndët e caktuara paraprakisht dhe për të cilat nuk do të shënohen

nota në dëftesa. Të gjitha provimet do të mbahen me laps dhe letër, pasi forma elektronike është provuar me testimet eksterne si e pasigurt dhe me shumë probleme. Në listën e provimeve eksterne të Maturës shtetërore është në mënyrë të patjetërsueshme lënda e gjuhës amtare apo gjuhës në të cilën zhvil-

Ulet rritja natyrore, 117 vdekje më shumë se lindje

Shkup, 28 maj - Numri i fëmijëve të lindur të gjallë në tremujorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë është ulur për 1.6 për qind dhe arrin 5.255 fëmijë të lindur të gjallë, tregojnë të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikës. Numri i personave të vdekur në tremujorin e parë nga viti 2018 shënon ulje prej 11.4 për qind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit 2017 dhe arrin 5432, ndërsa prej tyre 22 janë fëmijë të porsalindur. "Të dhënat e ESHS tregojnë se rritja natyrore arrin 177, që do të thotë për aq persona është më i vogël numri i fëmijëve të lindur të gjallë nga numri i personave të vdekur. Numri i martesave të lidhura në këtë tremujor të këtij viti është ulur për 1,3 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë nga viti 2017 dhe arrin 2.532 martesat. Në këtë tremujor janë marrë 250 raporte për divorce. (D.K.)

MASA DISIPLINORE PËR PROKURORËT QË ZVARRITËN HETIMET

Geshkovska do të përgjigjet për 27 prillin

Shkup, 28 maj - Ndarja e ngjarjeve të 27 prillit në më shumë lëndë është arsye kryesore se pse prokurorët Zlatko Bikovski, Jovan Cvetanoski dhe Gordana Geshkovska, pritet të përballen me përgjegjësi disiplinore. Ish-shefi i Prokurorisë së Shkupit, Bikovski dhe ish-shefja e Prokurorisë për krim të organizuar, Geshkovska, siç kanë njoftuar nga Prokuroria Publike, duhet të përgjigjen se si rasti i Ziadin Selës u kategorizua si "tentim vrasje" dhe pse i njëjti nuk iu bashkangjiti veprës penale "krim i organizuar". Për kryeprokurorin Lubomir Jovevski, ky hetim aspak nuk është dashur të ndahet nga lënda e plotë e 27 prillit dhe se sulmi ndaj Selës nuk është dashur të hetohet nga Prokuroria e Shkupit. Përfshirja e prokurorëve në ngadalësimin apo zvarritjen e hetimeve për ngjarjet e 27 prillit të vitit 2017, siç njoftojnë nga Prokuroria Publike, për momentin do të he-



tohet vetëm në aspektin e përgjegjësisë disiplinore, respektivisht nga kjo prokurori nuk japin detaje për përgjegjësinë e mundshme penale të prokurorëve në fjalë. Një Komision brenda Prokurorisë Publike, gjatë dy javëve në vazhdim duhet të shpallë vendimin për përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve Bikovski, Geshkovska e Cvetanoski. Ndërkohë, me një përgjegjësi të tillë nuk do të përballen ish-krye-

prokurori Marko Zverlevski, i cili më nuk është pjesë e prokurorisë. Sanksionet më të larta që mund të shqiptohen nga komisioni në fjalë, sipas dispozitave ligjore, është Propozim-vendimi për shkarkim të prokurorëve nga detyra, me çka vendimin e tillë e zbaton Këshilli i Prokurorëve Publikë. Ndryshe, për hyrjen e dhunshme në Parlament në prill të vitit të kaluar, deri më sot Gjykata Penale e Shkupit ka shqiptuar

vetëm një dënim efektiv edhe atë kundër sulmuesit të Radmilla Shekerinskës, i cili fillimisht u dënua me 4 vite burg, ndërkohë Gjykata e Apelit e uli dënimin në dy vite e gjysmë. Tutje, në proces gjyqësor vazhdon gjykimi kundër sulmuesve të Selës, gjegjësisht opinioni është në pritje të caktimit të datës se kur pritet të fillon procesi gjyqësor kundër 34 të dyshuarve për veprën penale "terrorizëm". (O.Xh)

ANKESA NË GJYKATËN E APELIT EDHE PËR NJË KOHË S'DOJETË GATI

Krahas përkthyesve, në këtë Gjykatë përfaqësimi i duhuri shqiptarëve mungon pothuajse në të gjitha sektorët dhe nivelet. Burime brenda GJPSH-së për gazetën KOHA thonë se nga numri i përgjithshëm i administratës gjyqësore -100, në këtë gjykatë nuk punojnë më tepër 13 shqiptarë

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 28 maj - Aktgjykimi kundër 35 shqiptarëve të akuzuar për ngjarjet e Kumanovës të vitit 2015, në Gjykatën Penale të Shkupit (GJPSH) ende nuk është përkthyer. Pavarësisht faktit se kanë kaluar mbi 7 muaj që kur janë shqiptuar dënimet kapitale dhe ato me burg të përjetshëm, shqiptarët e dënuar për "Lagjen e Trimave", kryesisht shtetas të Kosovës akoma nuk e kanë pranuar vendimin e gjykatës. Për zvarritjen e dorëzimit të këtij vendimi të rëndësishëm për ecurinë e mëtutjeshme të procesit gjyqësor për "Grupin e Kumanovës", burime të gazetës KOHA, flasin se janë të vetëdijshëm edhe drejtuesit e Gjykatës. Në këtë drejtim siç mëson gazeta KOHA, disa prej të akuzuarve pasi e kanë kuptuar se përkthimi mund të zgjatet ende, kanë kërkuar që aktgjykimi t'ju dorëzohet në gjuhën maqedonase.

"Më të vërtetë bëhet fjalë për një material voluminoz dhe përkthyesit tanë janë duke punuar në përkthimin e vendimit nga maqedonishtja në shqip. Ne ballafaqohemi me mungesë të përkthyesve shqiptarë dhe për këtë arsye kemi kërkuar përkthyes nga Gjykata e Apelit. Ndërkohë, dy prej të dënuarve kanë parashtruar kërkesë që aktgjykimi t'ju dorëzohet në gjuhën maqedonase dhe në këtë e kemi bërë", thonë nga GJPSH-ja, pa precizuar se kur pritet që ky vendim në shqip t'ju dorëzohet të dënuarve për "Lagjen e Trimave". Përkundër asaj se aktgjykimin për "Lagjen e Trimave" GJPSH u ka dorëzuar avokatëve, lënda nuk mundet të ankimohet para Gjykatës së Apelit derisa e njëjta nuk ju dorëzohet edhe të dënuarve.

Mungesën e kuadrit të përshtatshëm në GJPSH më së mirë e shpjegon fakti se përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i etnisë jo maqedonase, në këtë rast të shqiptarëve, nuk është i respektuar konform 25 përqindëshit të kërkuar me ligj. Krahas përkthyesve, në këtë Gjykatë përfaqësimi i duhuri i shqiptarëve

"KUMANOVA" PENG I PËRKTHIMIT



mungon pothuajse në të gjitha sektorët dhe nivelet. Burime brenda GJPSH-së për gazetën KOHA thonë se nga numri i përgjithshëm i administratës gjyqësore, në këtë dikaster nuk punojnë më tepër 13 shqiptarë. Nga daktilografët e deri te nëpunësit gjyqësor nëpër sportele, shqiptarë rrallë pak mund të vërehen në GJPSH, ndërsa numri i administratës gjyqësore i kalon 100 nëpunës gjyqësor të angazhuar në kohë të pacaktuar dhe të caktuar. Një shkallë e ulët e përfaqësimit kur jemi të GJPSH-ja, po ashtu është konstatuar dhe te numri i gjykatësve që janë të angazhuar në procedimin dhe shqyrtimin e lëndëve nga rastet për kundërvajtje e deri te ato për krim të organizuar. Megjithatë, qëndrimi i kësaj gjykatës është se caktimi dhe zgjedhja e gjykatësve është kompetencë e

Këshillit Gjyqësor. Sistematizimi i duhuri i shqiptarëve nëpër organet shtetërore dhe ato gjyqësore, edhe pse duhej të përmbushje vite me parë, fatkeqësisht kjo zbrazëtirë e vazhdon të mbizotërojë edhe sot. Ndryshe, siç njoftojnë nga Gjykata Penale e Shkupit, kuorumi i plotë i gjykatësve që duhet t'i procedojnë lëndët dhe shqyrtojnë rastet nuk është i përmbushur sipas normave ligjore. Trendi i zvogëlimit të numrit të gjykatësve ndër vite, fenomen ky i cili u përmend në Raportin e fundit të Këshillit Gjyqësor, më së miri shpjegohet se në GJPSH mungojnë rreth 20 gjykatës, gjegjësisht nga 70 gjykatës sa duhet të punojnë, në gjykatën më të madhe të Maqedonisë e cila e heton krimin e organizuar dhe së fundmi lëndët e Prokurorisë Speciale Publike, punojnë vetëm 51 gjykatës.

AMNISTIA E IVANOVIT DUHET TË SHQYRTOHET

Thirrjet e të akuzuarve në lëndët e PSP-së, se ato njëherë janë amnistuar nga presidenti Gjorgje Ivanov, nuk dihet se sa qëndrojnë. Riaktualizimi i temës së amnistisë, të cilët presidenti Ivanov e publikoi për pjesën dërmues të të akuzuarve të PSP-së, së fundmi është përmendur edhe te Gordana Jankullovska dhe Ilija Dimovska, si të dyshuar në rastin "Titanik". "Kjo çështje duhet të shikohet nga dy kënde. Fillimisht vlerësohet se nevojitet të vërtetohet e drejta e presidentit Gjorgje Ivanov, se vallë ka mund t'i amnistion të dyshuarit dhe në bazë të cilit nen të kornizës ligjore ai ka vepruar kështu. Po ashtu, duhet të hetohet se vallë ky vendim ka qenë i plotfuqishëm. Gjatë vlerësimit të aktakuzës, vendimet për amnisti ishin të refuzuara, ndërkaq aktakuzat u përfshinë në procedurë gjyqësore", ka thënë kryetari i GJPSH-së, Ivan Xholev.

Mbrojtja e zyrtarëve të VMRO-së kërkon të paditen gazetarët!

Shkup, 28 maj - Tre gazetarë, të cilët kanë shkruar artikuj për zgjedhjet e vitit 2011, është dashur të marrin kallëzime penale për shkelje të rendit dhe qetësisë publike, e jo t'u pranohet dëshmia në PSP, theksoi dje avokatja e Katerina Velovkës, e akuzuar në lëndën e PSP-së "Titanik" në fjalët hyrëse të procesit. Ajo në seancë tha se Gjykata nuk është dashur t'i marrë parasysh dëshmitë

e gazetarëve Mlladen Çadikoski, Sashka Cvetkovska dhe Natasha Stojanovska, sepse derisa e kanë krijuar artikullin e tyre gazetaresk për zgjedhjet, janë paraqitur tek votuesit dhe janë prezantuar se janë nga qendra për komunikim të VMRO-DPMNE-së. Mbrojtja e Velovkës konsideron se ata kanë kryer shkelje të rendit dhe qetësisë publike.



KRONIKË

Një burrë i vdekur gjendet në një banesë në Tetovë

Një burrë i vdekur është gjetur në një banesë në Tetovë, pasi fqinjët në polici kanë denoncuar se nga banesa është përhapur erë e pakëndshme. Siç informojnë nga MPB, dje rreth orës 10:20 në SPB Tetovë, S.O (45) nga Tetova ka denoncuar se në një banesë në rr. "121", ku ka jetuar B.P (75), në ditët e fundit ndjehet erë e pakëndshme. Nëpunësit policorë kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe në banesë kanë gjetur një burrë të vdekur. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekip i SPB Tetovë, prokurori publik dhe mjeku i mjekisë ligjore, me ç'rast është gjetur pasaporta dhe librezja e shëndetësisë së pronarit të banesës B.P. Me urdhër të prokurorit publik, trupi i të vdekurit është dorëzuar në Institutin për mjekësi ligjore në Shkup për obduksion.

Shkup, 7 të lënduar në 31 aksidente

Shtatë persona kanë marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa 17 janë më pak të lënduar në 19, prej gjithsej 31 aksidenteve të regjistruara në tre ditët e fundit në rajonin e SPB-së Shkup. Policia e komunikacionit ka sanksionuar 502 shoferë të cilët kanë qarkulluar me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, ndërsa ka përjashtuar nga komunikacioni 98 shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit. Nga komunikacioni janë përjashtuar 56 automjete të paregjistruara, 144 automobila të cilat janë parkuar në mënyrë të paligjshme, ndërsa me automjetin special karro-trec janë mënjeluar 26 automjete. Dy këmbësorë e kanë kaluar rrugën në dritë të kuqe, ndërsa 17 shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe. Një shofer nuk u ka dhënë përparësi kalimi këmbësorëve, tre kanë kaluar në mënyrë të padrejtë, një ka arritur në mënyrë të padrejtë, derisa sërish tre shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimi automjeteve në zonë të udhëkryqeve.

Djali shpon me thikë babain

Të shtunën pasdite, në rrugën "Nikolla Parapunov" në Gostivar, pronë e S.S, ka ardhur deri tek mospajtimi me djalin e tij B.S 40 vjeçar. Në një moment, djali me thikë i ka shkaktuar plagë në bark. Mënjëherë është dërguar në Spitalin e Gostivarit ku edhe i është dhënë ndihma e parë, por për shkak të seriozitetit të lëndimeve është dërguar në Klinikat e Shkupit. Hetim në vendin e ngjarjes kanë kryer ekipet e policisë së Gostivarit dhe janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

(O.XH)

KRONIKË

Dy 17 vjeçarë sulmohen nga dy minoren

Të dielën rreth orës 1.30 minuta, dy 17-vjeçarë nga fshati Pallçisht i Poshtëm, në prezencë të prindërve të tyre kanë denoncuar se më 26 maj, rreth orës 22.30 minuta në afërsi të stadiumit të vogël të fshatit, fizikisht janë sulmuar gjithashtu nga dy minorenë të tjerë nga fshati Kallnik të moshës 15 dhe 16-vjeçare. Të sulmuarit janë dërguar në Spitalin klinik të Tetovës për marrje të ndihmës mjekësore pas lëndimeve që kanë pësuar nga sulmi fizik. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e plotë të rastit.

Policia kontrollon shpejtësinë e automjeteve në trafik

Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë edhe përgjatë këtij vikendi ka kryer kontrole dhe aktivitete në komunikacion, ku më së shumti është kontrolluar shpejtësia me të cilën lëvizin veturat në autostradë, në rrugët magjistrale dhe regjionale në rajon. Në këto kontrole janë zbuluar 12 vozitës, të cilët jashtë vendbanimit e kanë tejkaluar shpejtësinë e lejuar maksimale për 30 deri 70 kilometra në orë. Krahas kësaj, gjithashtu janë zbuluar edhe 16 vozitës, të cilët kanë tejkaluar shpejtësinë në vendbanime, prej të cilëve 11 e kanë tejkaluar shpejtësinë maksimale për 30 deri 50 kilometra në orë. Kundërvajtjet e konstatuara për shpejtësi, sipas Ligjit për siguri në komunikacion dhe rrugë, janë përkufizuar me 25 fletpagesa të detyrueshme për kundërvajtje dhe me 3 vërejtje me shkrim, duke përmendur se gjobat për këtë lloj të kundërvajtjeje lëvizin prej 20 deri 400 euro në kundërvlerë të denarit, ose këmbim me pika negative prej 20 deri 65 pika, duke u llogaritur në bazë të shpejtësisë që e kanë tejkaluar. Për ata të cilët brenda dhe jashtë vendbanimeve e kanë tejkaluar shpejtësinë e lejuar, mbi 30 kilometra në vendbanim dhe mbi 50 kilometra jashtë vendbanimit, janë të parapara edhe masa mbrojtëse, ku leja për vozitje përkohësisht merret në afat prej 3 muaj deri më 1 vjet.

Vdes një vajzë pesëvjeçare në Shkup

Një vajzë pesëvjeçare dje ka vdekur në oborrin e shtëpisë, pronë e babait A.S.M në Shkup. Siç kumtoi MPB-ja, dje në orën 15:36 nga Spitali i Përgjithshëm i Qytetit "8 Shtatori" është paraqitur në Njësinë për informacione dhe komandë Shkup, se te ata është sjellë një vajzë e vdekur. Me urdhër të prokurorit publik, trupi i fëmijës së vdekur është dorëzuar për autopsi. (U.H)

FONDET EVROPIANE DHE KOMUNAT

TË HOLLAT EVROPIANE, JO VETËM VJELJE FRUTASH

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 maj - Shfrytëzimi i fondeve të ndryshme evropiane për komunat në Maqedoni nuk duhet të shikohet si një vjelje e thjeshtë e frutave, por si një proces që i paraprin përgatitjes, koordinimit dhe planifikimit serioz nga ana e kapaciteteve administrative komunale dhe organizatat e ndryshme joqeveritare. Gjithashtu, duhet marrë parasysh se shfrytëzimi më i madh i fondeve evropiane kërkon harmonizimin e strategjive të ndryshme zhvillimore vendore me ato të Bashkimit Evropian që vendosen në korniza shtatëvjeçare.

Sipas Ljupço Petkovski, kryetar i Organizatës joqeveritare "EvoTink", fondet evropiane në përgjithësi kanë një dimension zhvillimor evropian që përkon me qëllimet e politikave të përbashkëta të BE-së e që nevojitet të jenë komplementar me politikën zhvillimore vendore të Maqedonisë.

"Fondet evropiane nuk janë thjeshtë një vjelje frutash siç paragjykohet shpesh në Maqedoni, por ato kanë një bazament stabil dhe përgatitje serioze të buxheteve shtatëvjeçare, si dhe arritjes së qëllimeve të njëjta të Evropës së bashkuar. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të fondeve të ndryshme evropiane duhet pasur parasysh se ato nuk duhet të shikohen vetëm si vjelje frutash, por duhet marrë parasysh faktin e ato kanë rrënjë, degë që në fund japin edhe fruta. Me fjalë të tjera, ato planifikohen në kuadër të buxheteve dhe qëllimeve shtatëvjeçare, ose periudhës 2014-2020", shton më tej Petkovski.

Sipas tij, opinioni në Maqedoni duhet të merr parasysh edhe faktin se nevojitet me kohë të lobohet para BE-së por edhe para pushtetit qendror nga ana e komunave dhe organizatave joqeveritare, me qëllim që edhe çështjet e ndryshme vendore të inkuorohen në programet e ndryshme zhvillimore.

Ai më tej ka shpjeguar edhe mënyrën e njëanshme se si tek ne përfytyrohet procesi i fitimit të projekteve. "Ekziston një anekdotë për atë se ku janë komunat lidhur me fondet evropiane që tregojnë se për to janë të angazhuara ose sektorët për bashkëpunim ndërkombëtar ose ato për politikë jashtë-



Shfrytëzimi i fondeve të ndryshme evropiane për komunat në Maqedoni nuk duhet të shikohet si një vjelje e thjeshtë e frutave, por si një proces që i paraprin përgatitjes, koordinimit dhe planifikimit serioz nga ana e kapaciteteve administrative komunale dhe organizatave të ndryshme joqeveritare

me, ndërkohë që harrojmë se të gjitha 35 kapitujt për të cilat nesër do të negociojmë për tu anëtarësuar në BE, kanë të bëjnë me politikën e brendshme. Andaj, në të ardhmen nevojitet të ndërtohen kapacitete lidhur me fondet evropiane në të gjitha sektorët dhe jo vetëm në këto dy sektorë", thotë Petkovski.

Në ndërkohë, në kuadër të projektit Mekanizmi konsultativ lokal për IPA 2, do të lokalizohen aktivitetet për përmirësimin e kapaciteteve dhe performancave të qytetit të Shkupit, Tetovës, Strumicës dhe Manastirit në procesin e tërheqjes së fondeve IPA.

"Kjo paraqet një projekt inkluziv që nënkupton edhe bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, trajnime... Parashikohen një sërë trajnimesh për mbindërtimin e kapaciteteve të administratës si dhe përgatitjen e planit aksional për qasjen

ndaj aplikimit ndaj fondeve evropiane", thotë Ljubiça Jançev, kryetare e Këshillit të qytetit të Shkupit.

Në ndërkohë, në kuadër të projektit, deri në fund të muajit shtator do të ketë trajnime të ndryshme për rritjen e kapaciteteve të administratës në komunale dhe sektorit civil lidhur me fondet evropiane.

Ndryshe, analizat e kapaciteteve për shfrytëzimin e fondeve evropiane të përgatitura nga OJQ Info-Qendra tregojnë se vullneti ekzistues në Qytetin e Shkupit duhet të shndërrohet në masa dhe aktivitete konkrete që do të sjellin shfrytëzim më të madh të fondeve që ofron BE. Qyteti i Shkupit duhet të sajojë dhe zbatojë promovim të vazhdueshëm sistemor të përfitimeve nga pjesëmarrja në programet evropiane si për Shkupin, ndërmarrjet publike, organizatat joqeveritare, sektorin e biznesit, ashtu edhe për qytetarët në përgjithësi. Nga ana tjetër, vullneti ekzistues në Komunën e Strumicës dhe mungesa e barrierave politike duhet të kalojnë në masa dhe aktivitete konkrete që do të rrisin shfrytëzimin e fondeve evropiane, në pajtim me kornizën e zhvillimit strategjik të komunës. Gjithashtu, komuna nevojitet që të vazhdojë të promovojë në mënyrë sistemore për të gjitha palët duke filluar nga qytetarët e deri tek sektori i biznesit apo ai joqeveritar. Modeli i bashkëpunimit lokal në këtë komunë mund të promovohet edhe si praktikë e mirë edhe në komunat dhe rajonet e tjera në shtet. Për Komunën e Tetovës dhe atë të Manastirit, akoma nuk është shpallur analiza e Info-Qendrës lidhur me fondet evropiane.

Tragjike, ndërron jetë 43-vjeçari nga fshati Sllupčan

Kumanovë, 28 maj - Ka ndërruar jetë 43-vjeçari Bardhyl Zymberi nga fshati Sllupčan i Likovës, i cili të premten, u godit rëndë nga largpërçuesi i rrymës elektrike në vendkalimin kufitar Tabanoc. Ditën kritike, si punonjës i inspektoratit të Ministrisë së Ekologjisë, Bardhyli bënte inspektimin e trenit transportues i cili ka udhëtuar në relacionin Hungari-Greqi, dhe i cili ka qenë në kompozim prej 15 vagonëve. Ai ishte ngjitur në vagonin-cisternë prej të cilit rridhte na-

triumhiperklorid dhe derisa ishte mbi njërin prej tyre, me gjasë ka prekur telat e rrymës së tensionit të lartë, ndërsa ai është hedhur nga cisterna në tokë. Bardhyli kishite pësuar djegie të rënda nëpër tërë trupin dhe me ekip të Ndihmës së Shpejtë, është dërguar në Qendrën medicinale në Kumanovë, prej ku është udhëzuar për në kompleksin e klinikave "Nëna Terezë" në Shkup. Pas vetes, Bardhyli la dy fëmijë të mitur - një vajzë dhe një djalë.



DY PREZANTIME "SHQIP" NË 40 NET

"VERA E OHRIT", NJË EDICION SI TË TJERËT

Teatri Shqiptar i Shkupit dhe interpretuesi nga Shqipëria, violinisti Elvin Hoxha, janë ndër përfaqësuesit e vetëm në këtë edicion, ku pritej që të mos mungonin emra të njohur të muzikës të cilët vitin e kaluar ishin planifikuar të merrnin pjesë. Prej disa vitesh interesimi për prezencën e artistëve shqiptarë që performojnë në botë ka ardhur duke u reduktuar, së bashku me numrin e tyre



Sipas ministrit të Kulturës, Robert Alagjovzovski, kjo ngjarje për cilësinë në përmasa botërore që ofron është përfaqësuese e fuqisë unifikuese të kulturës.

"Këtë vit do të kemi një festival të shkëlqyer, të mbushur me koncerte dhe shfaqje, për të cilat presim që të provokojnë refleksione dhe polemika, të çelin horizonte të reja, të jenë provokime artistike dhe të sjellin risi e freski për Ohriton", ka thënë ministri në konferencën e organizuar të hënën në këtë qytet. Organizatorët e këtij festivali, në prezantimin e programit të këtij viti kanë paralajmëruar prezencën e artistëve nga vende si Rusi, Japoni, Kanada, Kubë, Kinë, Spanjë, Itali, Francë, Bullgari, Turqi... dhe ish republikat e Jugosllavisë. Soprano Elena Moshuc, e njohur si Mbretëresha e natës është ylli i këtij edicioni, që së bashku me baritonin Kalin Bratesku po nga Rumania, dirigjentin Nilollae Moldoveanu dhe orkestrën e Filarmonisë së Maqedonisë do të hapin festivalin më 12 korrik në Teatrin Antik. Edhe mbyllja e festivalit sipas organizatorëve parashikohet të jetë spektakolare, me "Iliadën" e Homerit, shfaqjen teatrore të regjisorit Jernej Lorenci. Kështu ka deklaruar selektori i programit të dramës, Aleksandër Popovski, duke e cilësuar këtë

shfaqje si projektin më të madh të shfaqur në Teatrin Antik. Shfaqjet e tjera janë prezantime kryesive të teatrove vendase, por edhe të ftuar nga Serbia, Kroacia dhe Sllovenia.

Gjatë këtij festivali do të dominojë muzika klasike dhe emra legjendarë të muzikës botërore, ka deklaruar selektori i muzikës, Vaso Ristov. Ai ka përmendur emra si Nikollaj Liganski, Aleksandër Knjazev, Antonio Serano, Sergej Krillov, e të tjera. "Është nder të prezantojmë programin cilësor të 40 ditëve të festivalit, që janë festë për artin e manifestimit më të madh muziko-skenik, që nga viti në vit e shkruan historinë e vet me emra të famshëm të elitës botërore të muzikës dhe kreacioneve teatrore. Ju siguroj se risitë që do t'i sjellë ky edicion do të çojnë më tej traditën e suksesshme, por njëherazi do të bartin edhe dimensionin modern që do të pasurojë historinë e këtij festivali", ka thënë ndër të tjera drejtoresha e Verës së Ohrit, Suzana Vrencovska. Meqenëse vetë festivali zhvillohet në skenat më atraktive të qytetit, Ministria e Kulturës këtë vit një pjesë të fondeve ia ka akorduar sanimit të mjedisve ku do të performojnë artistët, si skena e Sarajit të poshtëm rikonstruktimi i së cilës do të kushtojë 1,4 milionë denarë.

Incidenti në Reçicë, paraburgim deri në shpallje të dënimit

Shkup, 28 maj - Prokuroria Themelore Publike Tetovë përmes një kumtese informon se gjatë përgatitjes të Propozimit të veçantë për Aktakuzën dhe Propozimin akuzues për personat të përfshirë në ngjarjen e armatosur në Reçicë të Vogël, është bërë lëshim i paqëllimtë teknik. Siç theksojnë, në propozimin të dërguar deri te gjykata adekuate qëndron se prokurori publik, i cili punon në lëndën ka propozuar masë paraburgimi "deri në shpalljen e dënimit" për një pjesë të personave të përfshirë me aktakuzën.

"Theksojmë se bëhet fjalë për mbikëqyrje dhe gabim teknik, i cili menjëherë është përmirësuar dhe Aktakuzat dhe Propozimi akuzues të korrigjuara janë dërguar deri te gjykata adekuate. Në pajtim me këtë, është bërë përmirësim i informacionit për aktakuzat e ngritura, të dorëzuara deri te mediat", theksojnë nga PTHP Tetovë. Në informatën e korrigjuar të publikuar në ueb faqen e Prokurorisë Publike të RM-së, qëndron "Prokurori adekuat deri te Gjykata Themelore Tetovë propozoi tre të akuzuarve të cilët janë privuar nga liria, si dhe një të akuzuar i cili edhe më tutje është në arrati, tu vazhdohet paraburgimi". Ndryshe, dy muaj më parë, në afërsi të selisë së BDI-së në Reçicë të Madhe, gjatë një përleshje me armë zjarri mes dy grupesh politike rivale nga Kumanova, mbeti i vrarë Naip Rexhepi nga Kumanova, u plagos vëllai i tij, si dhe u plagos rëndë edhe një i ri nga fshati Çerkez i Kumanovës.

Koha

Evis HALILI

Shkup, 28 maj - Edicioni i 58-të i festivalit "Vera e Ohrit" këtë vit do të ngjisë në skenë rreth 800 artistë nga 27 vende të botës, emra të njohur të muzikës dhe teatrit. Por në manifestimin me më renome muziko-skenik, numri i artistëve shqiptarë që do të performojnë është shumë i vogël. Teatri Shqiptar i Shkupit dhe interpretuesi nga Shqipëria (violinisti Elvin Hoxha), janë ndër përfaqësuesit e vetëm në këtë edicion, ku pritej që të mos mungonin emra të njohur të muzikës të cilët vitin e kaluar ishin planifikuar të merrnin pjesë. Prej disa vitesh, interesimi për prezencën e artistëve shqiptarë që performojnë në botë ka ardhur duke u reduktuar, së bashku me numrin e tyre. Teatri Shqiptar i Shkupit do të prezantohet me "Vdekjen e Dantonit", me regji nga Dino Mustafiq, premiera e së cilës u dha pak ditë më parë. Shfaqja është planifikuar të luhet më 22 korrik, në Qendrën e Kulturës së qytetit "Gligor Përliçev". Ndërsa performanca e vilionistit Elvin Hoxha do të jetë në kishën e Shën Sofisë, më 15 gusht, i shoqëruar nga pianisti Vladimir Glladkov nga Ukraina.

Sërish shtrenjtohet benzina dhe dizeli

Shkup, 28 maj - Çmimet e shitjeve me pakicë të benzinave dhe dizelit prej mbrëmë në mesnatë rriten për dy denarë, vendosi Komisioni rregullator për energjetikë. Sipas Vendimit, çmimi ri i Eurosuper BS-95 do të jetë 73,50 denarë për një litër, Eurosuper BS-98 do të shitet nga 75,50 denarë, Dizeli do të shitet nga 65 denarë, ndërsa Vaji ekstra i lehtë për amvisëri 54 denarë për litër. Rritet edhe çmimi i mazutit dhe do të arrijë 34,53 denarë për kilogram. Çmimi mesatar i naftës së papërpunuar në tregun botëror në periudhën 14 ditore ka arritur 78,68 dollarë për fuçi, ndërsa kursi i denarit në raport me dollarin 52,06 denarë.

Kodi etik i deputetëve më 11 qershor në Parlament



Shkup, 28 maj - Propozim-Kodi etik i Parlamentit, i cili u harmonizua nga ana e grupeve të deputetëve në takimin e parë në kuadër të procesit Zhan Mone në Ohër, do të vendoset në rend të ditës të caktuar për 11 qershor, njoftoi MIA. Në vijim është nënshkrimi nga ana e kryetarit, nënkryetarët dhe koordinatoret e grupeve të deputetëve të Propozim-Kodit etik, i cili gjatë javës edhe zyrtarisht do të hynte në procedurë të Parlamentit. Qëllimi i miratimit të këtij dokumenti është respektimi i rregullave themelore etike dhe afir-

mimi i dinjitetit për ruajtjen e autoritetit të Parlamentit dhe të deputetëve. Kodi etik përmban kapituj me parime, opinion dhe përgjegjësi, për respektimin e ndërsjellë dhe respektimin e integritetit personal të tjerëve, rregullat themelore të sjelljes, rregullat për pengimin e përplasjes së interesave, ndalesë për korrupsion dhe dhurata... Për ndryshimet e Rregullores së Parlamentit, të cilat ishin po ashtu një nga çështjet kryesore të Procesit "Zhan Mone", grupet e punës të partive politike, sipas marrëveshjes, duhet defini-

tivisht të prononcohen deri nga mesi i qershorit. Propozim-ndryshimet e tilla të Rregullores do të vendosen në procedurë të Parlamentit. Anëtarë të grupeve të punës të partive parlamentare janë të njëjtë të cilët morën pjesë në bisedat në Ohër. Bisedat në kuadër të Procesit Zhan Mone janë inicuar nga tre eurodeputetët Ivo Vajgël, Eduard Kukan dhe Knut Flekenshtajn. Përveç Propozim-Kodit etik, në seancën e 47-të në rend të ditës është Raporti për përpunimin e KE-së për Republikën e Maqedonisë.


**QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT**

Në bazë të nenit 50, paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 23 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 38/1996; 9/1997; 6/2002; 40/2003; 49/2006; 22/2007; 83/2009; 97/2010; 6/2012; 119/2013; 41/2014; 138/2014; 25/2015; 61/2015; 39/2016 dhe 64/2018), dhe në pajtim me Vendimin për publikimin e shpalljes publike për zgjedhjen e Drejtorit të NP "Higjiena komunale" nr. 08 - 4474/1 të datës 18.05.2018, Kryetari i Qytetit të Shkupit, publikon:

**SHPLLJE PUBLIKE
për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike
"Higjiena komunale" – Shkup**

- Kandidatët për zgjedhjen e drejtorit duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - të jenë nënshtruar të Republikës së Maqedonisë;
 - të posedojnë së paku 240 kredi sipas ECTS ose të kenë përfunduar nivelin VII/1 të arsimit;
 - në momentin e emërimit, me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - të posedojnë së paku pesë vite të përvojës së punës;
 - të posedojnë një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare ose të vërtetimeve për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetra se pesë vite, me sa vijon: TOEFL IBT (TOEFL iBT) – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë, ILEC (ILEC Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE Cambridge English: First) provimi i dhënë ose BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë, ose APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2).
- Vërejtje: nëse kandidati nuk e përmbush kushtin e paraparë në pikën 1 alinea 5 nga kjo shpallje në lidhje me njohjen e gjuhës angleze, ai është i obliguar që këtë kusht ta përmbush në afatin prej një viti nga dita e emërimit të tij, në të kundërtën atij do të pushohet mandati** (në pajtim me nenin 13 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për ndërmarrjet publike – Gazeta zyrtare e RM-së nr. 64/2018).
- Kandidatët për drejtor, përkaj dëshmime për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura duhet të dorëzojnë edhe dokumentet vijuese:
 - fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
 - propozim programin e punës dhe zhvillimit të ndërmarrjes.
- Dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët janë të detyruar që ta dorëzojnë në original ose kopje të verifikuar te noteri.
- Afati i parashtrimit të dokumentacionit të nevojshëm është 7 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.
- Fletëparaqitjet e kandidatëve dorëzohen deri te arkivi i Qytetit të Shkupit në barakën nr. 16 – me shenjën Kryetari i Qytetit të Shkupit – Për shpalljen publike për zgjedhjen e drejtorit të NP "Higjiena komunale" – Shkup.
- Drejtori zgjidhet me mandatin prej 4 viteve.
- Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

**Qyteti i Shkupit
Kryetari i Qytetit të
Shkupit
Petre Shilegov**

Në bazë të nenit 126 pika 7 të Ligjit për arsim fillor (Fl. Zyrtare e RM-së nr. 103/08) dhe shkresës nr. 08-866 të dt. 23.05.2018 të Kryetarit të komunës së Vrapëishtit, Këshilli i shkollës fillore "Naim Frashëri" Negotina e Pollogut, shpallë:

**KONKURS
për zgjedhjen e drejtorit të shkollës**

Kandidatët, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj (Fl. Zyrtare e RM-së nr. 103/08), neni 128 pika 3, duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta si në vijim:

- Fletëparaqitje,
- të kenë të kryer arsim të lartë sipëror dhe ti plotësojnë kushtet për (arsimtar, pedagog, ose psikolog në shkollën fillore).
- certifikatë për shtetësi,
- vërtetim për gjendjen shëndetësore,
- vërtetim për përvojën e punës në veprimtari edukativo-arsimore,
- vërtetim për provimin e dhënë për drejtor,
- vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për ndalimin e ushtrimit të punës ,profesionit dhe obligimeve.
- program pune për periudhën katër (4) vjeçare.

Dokumentet e pakompletuara dhe të arritura me vonesë nuk do të shqyrtohen.
Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditorë, kurse zgjedhja do të bëhet në afat të paraparë me ligj.
Dokumentet e nevojshme të dorëzohen në original ose të vërtetuara në noter deri te Këshilli i shkollës fillore "Naim Frashëri" Negotina e Pollogut.

Kryetar i Këshillit të shkollës

Vebi Sejdija

Në bazë të nenit 176 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2018), neni 9 dhe 10 të Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" (Fleta universitare nr. 274/13), Dekani i Fakultetit Filozofik në Shkup, publikon

**KONKURS
për zgjedhje të:**

- Një mësimdhënës (në të gjitha titujt mësimor-shkencor) në sferat shkencore në vijim:

- Historia e filozofisë nën numrin 60500
- Filozofia (kursi i përgjithshëm) – (Të tjera) nën numrin 60517.

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror *Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 82/18), kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Fakultetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtër, dokumente që dëshmojnë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.
Mësimdhënësit e zgjedhur lidhin marrëdhënie pune për kohën për të cilën zgjidhen.

Fletëparaqitjet së bashku dokumentacionin e kompletuar parashtrihen përmes arkivit të Fakultetit, ose përmes postës në adresën: bul. Goce Delçev nr. 9A, 1000 Shkup.
Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup
Fakulteti filozofik në Shkup

**ЈУ ГРАДСКА БИБЛИОТЕКА
„БРАКА МИЛАДИНОВИЌ“
СКОПЈЕ**



**IP BIBLIOTEKA E QYTETIT
"VËLLEZËRIT MILLADINOV"
SHKUP**

"IP Biblioteka e qytetit "Vëllezërit Milladinov" – Shkup, bul. "Partianski Odredi" nr. 22, në pajtim me nenin 10 paragrafi 3 dhe nenin 13 të Vendimit të Këshillit të Qytetit të Shkupit ("Fleta zyrtare e Qytetit të Shkupit" nr. 12/14) për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit, Vendimi i Këshillit drejtues nr. 02-283/7 të datës 14.05.2018 dhe pëlqimit nr. 08-4591/1 të datës 23.05.2018 të Kryetarit të Qytetit të Shkupit, publikon

SHPLLJE PUBLIKE

Për procedurën për grumbullim të ofertave të mbyllura dhe zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm për

- Dhënie me qira të hapësirës afariste për vendosje të aparatit për pije të ngrohta dhe të ftohta në lokalët e bibliotekës "Vëllezërit Milladinov" bul. "Partianski Odredi" nr. 22.

Pjesëmarrësit e interesuar mund të paraqiten me autorizim ose gjendje aktuale dhe të deponim të garancisë prej 2.000,00 denarë në ditën e zgjedhjes.

Zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm do të bëhet nga ofertat e mbyllura të parashtruara të pjesëmarrësve të paraqitur në arkivin e bibliotekës.

Shpallja zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit të saj.

Hapja e ofertave dhe zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm do të bëhet më datë 14.06.2018 në ora 10. Informacione në telefonin 3162 544 dhe 071 329 109 "Nga Komisioni"

Suzana
Danaillova
u.d drejtor



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

Njoftim

Universiteti i Evropës Juglindore shpall thirrje publike për sa vijon:

- Thirrje publike numër 02/052018 – Furnizim dhe montim i roletave të aluminit.

Të gjithë të interesuarit mund të marrin informata më të hollësishme në:

www.seeu.edu.mk/sq/information/tenders

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit ginekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Koha
E përditshme informative

<http://www.koha.mk>

Search

www.koha.mk
koha@koha.com.mk
marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup



Të anulohet Rregullorja për ashensorët

Shkup, 28 maj - Kompanitë nuk mund t'i përmbushin kushtet nga Rregullorja për ashensorë, të cilat parashohin ndërtim të pajisjeve shtesë të cilat kushtojnë së paku 5.000 euro dhe teknikisht gati të përcaktueshme. Për këtë shkak, kërkojnë takim me Qeverinë për anulimin e tij të serishëm. Siç u tha dje në konferencën për media në Odën Ekonomike, kushtet të cilat i vendos Rregullorja vlejné edhe për ashensorët më bashkëkohorë, relativisht më të rinj, nga viti 2008, 2009, 2010 sepse edhe një pjesë e tyre nuk i kanë pajisjet e kërkuara. Rregullativa e definuar kështu, edhe pse e bazuar në standardet evropiane, nuk respektohet në tërësi edhe në një numër të madh të vendeve anëtare të BE-së.

"Një paragraf nga neni 68 i Rregullores kërkon vendosje të pajisjeve për mbrojtje nga lëvizjet e jokontrulluara në kabinë të lartë. Nëse ky obligim implementohet, do të nënkuptojë investim të madh ose shpenzim prej minimum 5.000 euro që do ta bartin banorët. Nëse, përsëri, përjashtohet nga Rregullorja dhe nuk zbatohet, nuk do të vijë deri në dëmtim të funksionalitetit dhe sigurisë së ashensorëve", theksoi Daniela Mihajlovska Vasilevska nga Oda Ekonomike. Sipas kryetarit të Grupacionit për ashensorë, Dimçe Popovski, Rregullorja duhet të anulohet sepse nuk ka kushte për implementimin e saj, ndërsa janë detektuar edhe shumë lëshime, si dhe defekte në shumë segmente, duke përfshirë edhe servisimin. "Deri në vitin 2019 të gjithë ashensorët duhet të adaptohen në bazë të Rregullores, por kjo është thjeshtë e pamundur. Bëhet fjalë për investime shtesë prej së paku 5.000 deri 10.000 euro pa të cilat gjithsesi funksionaliteti dhe siguria e ashensorëve nuk do të dëmtohet", theksoi Popovski. Grupacioni për ashensorë nga viti 2009 kërkon edhe licencim të kompanive për ashensorë, por deri tani, siç informon Popovski, nuk ka kurrfarë rezultate. Rregullorja për ashensorë është sjellë më 24 shkurt të vitit 2009. Dy vite, nga 2016 deri 2018 implementimi i nenit 68 ishte anuluar, por në këtë periudhë problemi nuk u tejkalua. Në Maqedoni me këtë veprimtari merren rreth 20 kompani. (Z.V)

PREMTIME TË PAFUNDME PËR DY SHKOLLAT NË TETOVË

REÇICA DHE SELLCA PRESIN QEVERINË

Ndërtimin e shkollës në Reçicë të Vogël e premtoi edhe kryeministri Zoran Zaev gjatë vizitës në këtë fshat në kohën e fushatës për zgjedhjet lokale, duke nënvizuar se kjo shkollë do të jetë prioritet për Qeverinë

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 27 maj - Fshati Sellcë dhe lagjja Reçicë e Vogël ende janë në pritje se kur do të fillojnë punimet dhe kur këto dy projekte do të fillojnë të realizohen në praktikë. As në Reçicë as në Sellcë, nuk është nisur as nga pika zero. Për shkollën në Reçicë të Vogël vazhdojnë të jepen premtime të pafundme, kurse në terren ende asgjë konkrete nuk ka. Në këtë lagje banorët që moti kanë kërkuar ndërtimin e një objekti shkollor, por gjithnjë institucionet kanë gjetur mënyra për t'ju shmangur këtij investimi. Ministri i Arsimit, Arbër Ademi, theksoi se kjo shkollë është prioritet i ministrisë dhe Qeverisë, por pa precizuar se kur një gjë e tillë do të ndodh.

"Të dy shkollat, si në Reçicë ashtu edhe në Sellcë, janë në prioritetet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, por edhe të Qeverisë. Për këto dy projekte, në mënyrë më të detajuar do të informohemi nga zëvendëskryeministri Hazbi Lika dhe nga kolegët tjerë qeveritar dhe punojmë në mënyrë të vazhdueshme që të përmirësojmë infrastrukturën shkollore", deklaroi Ademi.

Më herët, edhe kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, theksoi se shkolla në Reçicë të Vogël është prioritet i mandatit katërvjeçar. Sipas kryetares Arifi, janë duke u bërë të gjitha përpjekjet që ky projekt të financohet nga buxheti i shtetit dhe presin që Qeve-



ria të miratojë në programin e vitit vijues.

"Mendoj se me këtë mandat do përfundoj ajo shkollë. Siç e dini historinë e shkollës, katërvjeçarin e fundit ishte në programin për tu realizuar me grand kinez, dhe ne kërkuam nga qeveria që të tërheq nga realizimi i atij grandin, por të vendos në buxhetin e saj. Jemi duke përfunduar edhe një revizion të dytë të lejes meqenëse projekti ka leje, është i plotë dhe presim që Ministria e Arsimit ashtu siç ka thënë edhe Qeveria, që ky projekt të realizohet", ka deklaruar Arifi. Ndërtimin e kësaj shkolle e premtoi edhe kryeministri Zoran Zaev gjatë vizitës në këtë fshat në kohën e fushatës për zgjedhjet lokale, duke nënvizuar se kjo shkollë do të jetë prioritet për Qeverinë. Edhe pse kishte një paralajmërim për një donacion të huaj se do të ndërtohet shkollë në këtë lagje të Tetovës, megjithatë deri më tash nuk është punuar asgjë në terren.

Madje, kishte deklarata të llojit se nëse nuk e financojnë kinezët, do ta ndërtojë Qeveria apo komuna, por sërisht asgjë. Në ndërkohë, rreth 700 nxënës të kësaj paralagje tetovare mësimin e ndjekin në këtë shkollë fillore e cila ka më shumë se 1700 nxënës. Shkolla është

ndërtuar në vitin 1969 me një kapacitet prej 700 deri në 800 nxënës, ndërsa tani numri i nxënësve është 1700, kurse gjysma e këtyre janë të lagjes Reçicë e Vogël. Prindërit e kësaj lagje që moti kërkojnë një shkollë, por assesi ky projekt të realizohet.

Nga ana tjetër, në fshatin Sellcë ku edhe atje është kërkuar shkollë e re për shkak se shkolla ekzistuese nuk i plotëson kushtet, sipas informacioneve zyrtare, për momentin janë duke u bërë analiza për qëndrueshmërinë e tokës në disa lokacione për shkak se në objektin që nisi të ndërtohet më herët, nuk mund të vazhdohet me punë sepse dheu është i rrëshqitshëm.

Objekti ekzistues ku mësojnë nxënësit e fshatit Sellcë është ndërtuar në vitin 1952 dhe prej atëherë disa herë janë bërë renovime të vogla. Ndryshe, kjo shkollë ka edhe dy shkolla periferike - një në Llacë dhe një në Vicë, ku mësojnë 576 nxënës dhe ka një kuadër prej 54 personave. Në shkollën qendrore të këtij fshati mësojnë 365 nxënës. Për objektet e reja shkollore në Reçicë dhe në Sellcë gjithnjë janë dhënë premtime se do të fillojnë të ndërtohen, por konkretisht nuk është bërë asgjë.

Në Gostivar do të ndërtohet Akua Park

Gostivar, 28 maj - Vetëqeverisja lokale e Gostivarit kërkoj procedurë për ndërtim të kompleksit për argëtim me Akua Park. Këndi i ri argëtues duhet të dalë përgjatë bregut të djathtë të Vardarit në lagjen Dutillok. Në konkursin të cilin javën e kaluar komuna e shpalli përmes sistemit elektronik për furnizime publike, kërkohet zgjidhje ideore për ndërtim të parkut të ujit me

përmbajtje shoqëruese. Autoritetet e komunës tashmë e kanë paraparë lokalitetin në PDU për bllokun 16 në zonën e cila është paraparë për aktivitete rekreative-sportive, ku tashmë ekzistojnë terrene sportive.

"Vendimi më i mirë i konkursit duhet t'i respektojë parimet themelore dhe të drejtat në projektimin e planifikimit urbanistik dhe do të merret për 50 mijë denarë.

Konkursi parasheh që të blihen edhe dy projekte ideore shtesë", thonë nga shërbimi për informim i komunës së Gostivarit. Prej aty potencojnë se ndërtimi do të jetë ekonomik për komunën dhe nuk do ta ngarkojë buxhetin e komunës, sepse realizimi i tërësishtëm do të jetë në parim të partneritetit publik-privat.

Me këtë projekt, autoritetet komunale të gostivarasve në të

ardhmen do të kenë në dispozicion përmbajtje të hapësirës ujore me mbi dy mijë metra katror. Akua parku i ardhshëm duhet të ketë: pishina për toboganë spiral, për toboganë të shpejtë me valë, lum dembel, pishinë të cekët për fëmijë deri në moshën katër vjeçarë, pishinë për fëmijë nga katër deri 14 vjet. "Ky projekt duhet të realizohet këtë vit, por për shkak të problemeve me votimin

min e buxhetit në Këshillin e komunës afati për realizimin u lëviz për vitin 2019", sqarojnë nga Komuna e Gostivarit. Krahas hapësirave teknike, parkingut, dhoma-ve të zhveshjes, toaletëve, në këtë kompleks duhet të funksionojnë një restorant dhe një kafiteri. Konkursi për zgjidhje ideore zgjat deri më 26 qershor, pas çka komisioni posaçëm do t'i vlerësojë dhe zgjedh tre më të mirët.

A kryheshka revolucioni...

Nga

Adelina MARKU



Kur njeriu përjeton edhe një revolucion në jetën e tij, e kur pas një Revolucionit të larmë e jo më larg se dje, ky -njeriu i tranzicionit (ose UNË e TI!), pra gjen veten të fitojë aftësinë e përjetshme të mbarset me revolucionin e të mbetet shtatëzënë me të deri në vdekje. Është kjo një shtatëzani e gjatë e mundimshme ngase aborton veten, pra ndryshimin që do vijke pas revolucionit! Të mos pjellësh as edhe një përtej-revolucion, por të ngulesh në një farsë të sërishme qeverisje revolucionare e cila në gjuhën e Georg Buchner "s'është asgjë tjetër përveçse një despotizëm i lirisë kundër tiranisë!", bën që jeta jonë të përjetohet revolucionarisht dhe asnjëherë me rehati për pragmë. Nga njeriu sot, nga qytetari i sotëm kërkohet që ai /ajo të kuptojë revolucionin (...duhesh kuptuar revolucionin!!!), t'i përshkojë trupit të tij (...duhesh bërë pjesë e tij!!!), t'i dalë përtej (...duhesh me duru e prituri ndryshimin!!!) e të kërkojë përsëri revolucionin (...ngase ndryshimi s'u bë as pas një pritjeje të gjatë!!!) ..., masnej të pyesë veten: "Përsëri revolucion!?", "A paska fund revolucionit?"...dhe për më shumë të vetëkërkohë: "Vdekje revolucionit..." dhe të shkruajë epitafe me: "Përqeshje revolucionit!"

Përjetova shfaqjen "Vdekja e Dantonit" me një lluks e rrëndesë njëkohësisht, sepse (pa)nevojën e revolucionit kam filluar t'a lidh me mungesën e lirisë tek ata që vendosin të udhëheqin me pasrevolucionin, pra me Republikën (Qeverinë e re). Në fakt këta nuk udhëheqin, këta lakmojnë, bëjnë afshimin e jo menaxhimin! Për habinë dhe lëngimin tim të madh, pushtetrët me vetëdije vrasin revolucionin tuj ia ngranë fëmijët atij! Kështu çlirojnë veten me gjasë tuj dasht me u xhvesh nga premtimet e revolucionit. Ky është edhe rrëfimi i dramës "Vdekja e Dantonit", shkruar nga Georg Bychner, vënë në skenë nga Teatri shqiptar në Shkup ndërsa nën rregjinë e Dino Mustafiq, një emër ky i spikatur i teatrit ish jugosllav, e spikatur piedestalesh tani përtej jugosllavit. Katarzike ishe rregjia e tij, e ngarkuar e ngopur me qartësi mesazhi t'Bychner-it, por edhe me aso Tepri të nevojshme që në kuptimin tim sikur ishin sistemuar me qëllim në pjesën teatrore sa për të sqaruar ngarkesën e përditshmërisë së shekullit digjital, nën ambiguitetin ushtrues të të cilit rastisëm të bëjmë jetën tonë të varfër. Janë dy heronj



gjithmonë, Robespjeri e Dantoni, ata që bashkë bëjnë revolucionin e që më vonë të shohin se si pikërisht idealin e revolucionit e thërmojnë ndrysh' e për t'a shiju njëri nga to fuqinë orgazmuese prej pushtetari. I pari, Robespjeri këtë fuqi orgazmuese e vendos në kupolë pushtetare, ai betohet në vrytete: "Vrytyti duhet të sundojë përmes tmerit"- dhe e shpall këtë ngjirim diskurs politik të pushtetit të tij. Është ky sistemi i mëndjes së tij që e inspiron të shohë tek Dantoni jo më mikun e shtrenjtë me të cilin bëri revolucionin por tradhtarin e madh, sepse ky -Dantoni është hedonisti, Njeriu i Lirisë, ai që vazhdon të besojë në inspirimin e revolucionit -në punën për liri e tolerancë, për shoqëri të barabartë e për të gjithë një-

soj! Kështu Robespjeri - nga lartësitë e pushtetit e shpall Dantonin tradhtar. Mesa duket ai më lehtë e ka të arsyetojë dështimin e pasrevolucionit përmes shpalljes tradhtar Dantonin e tuj e shndru veten ngadal - ngadalë në të gjithë fuqishmin, prandaj diktatorin. Diktatorët kanë aftësinë të vrasin të gjithë ata që duan të përfundojnë revolucionin e të shpallin sistemin e rëndit të qëndrueshëm si bazament shoqëror. Diktatorët inspironen nga tmerri gjer në spikamë vrytyti e kështu bëhen të pakontestueshëm. Për këta të gjithë janë të kontestueshëm e e kontestueshme është edhe liria e tyre, prandaj Robespjeri e çon në giljotinë mikun e tij të ngushtë Dantonin! Tuj e giljotinu Dantonin, ai në fakt i prët kokën lirisë.

Loja e trupit tetaror që vuni në skenë Vdekjen e Dantonit, edhe kur rrëshqiste në ndoj dis'hotoni eventuale kishte një linjë që të mbante në gumëzhim ndjenjat lartë. Këto ishin aktorët e rrinj që m'gëzojnë për vazhdimësinë e Teatrit shqiptar në Shkup. Vitalët që pasrevolucionet tona do i spikasin në sistem arti të gjallë për ne...



Gjenialiteti i Bychner-it është pothuajse iritues për mua, sepse drama që ky shkroi në vitin 1835 është po ajo që kish mundur t'a shkruajë në vitin 2018. Përjetësia e veprës së tij është madje e frikshme, revolucionin nuk po mer fund, ai dështon vazhdimisht e me qëllim sepse nuk mund të jetojë pa veten, pa vetënxitur një revolucionin të ri! Kështu ne vazhdojmë të jetojmë në një dimension revolucionar e të mundimshëm, pa e kry kurrë veten deri në fund. Ky dhe është thelbi i dramës së Bychnerit, "Vdekja e Dantonit" është moskrymja e vetes sonë!

I/e nderuar lexues/e, ju ftoj t'i ktheheni një teatri të këtitillë, le mos t'ju ikë mrekullia difuze e fantazisë së Bychner-it përmes trajtës së sistemit nga Mustafiq. Kompozimi, gjetja e këtij shpesh merte modelin e filmit tuj i ik traditaionale së teatrit. Për mua, ky ishte një përjetim i ri e i pazakontë, "i hapt... dhe i mbusht"! Dantoni përmes lojës së Refet Abazit e kapte deri në fije empatie të puthtë organikë e karakterit të Bychner-it tuj e lanë t'i rrjedhë lum vetja mes trajtash arti të padisciplinim, ndërsa porcelan'ja e plastikës së lojës së Luran Ahmetit në rolin e Robepjerit të bënte që pritesh gjak teht të saktësisë që buronte nga aktrimi i tij. Një bardhëzonë kjo maestrale! Muzika

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 28 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

e shfaqjes disi e dendun e e ngopt', por për mua merte kuptimin e asaj që e shkrova më lartë, Teprisë së nevojshme- që sikur projektonte ngarkesat vulgare të jetëve tona në këtë shekull të digjitalizum. Herë të dyndte gjer n' mishrim vajtus e herë në tranim ekstazus! Skenografia e thjeshtë, Urë e Qiell! Hej, aq janë edhe elementet e jetës sonë, një urë që definon (ç) ekuilibrin e jetës sonë drejt një Qielli (përfundimi) që e përcakton cilësia e atij (ç) ekuilibri! Skenografi minimaliste por me shumë gojë! Videogjetjet kulmonin me vibrime nga hapësirat e brendive tona plot ankth ndërsa adaptimi i tekstit te Bychner-it me realitetin akut tonin, bënin që drama e tij të projekton ditët tona me dënësje pafund. Kostumet që ngjisin dy botë, pushtetin e hekurorur tejmëtej dhe bluzat e përditshmërisë sonë që lypin lirinë, vllazërinë e barazinë ndërsa vallja e dansi, koreografia - sikur më sillnin fuqinë e gravitetit në formë mbispikame të gjithë lëvizjeve tona të mundimshme në jetë!

Loja e trupit tetaror që vuni në skenë Vdekjen e Dantonit, edhe kur rrëshqiste në ndoj dis'hotoni eventuale kishte një linjë që të mbante në gumëzhim ndjenjat lartë. Këto ishin aktorët e rrinj që m'gëzojnë për vazhdimësinë e Teatrit shqiptar në Shkup. Vitalët që pasrevolucionet tona do i spikasin në sistem arti të gjallë për ne shqiptarët këtu! Kështu e përjetova llavën e tyne asaj nate!

Me sa duket, tek vrisja mendjen pas' Dantonit, revolucionin nuk e njeht lirinë mjaftueshëm, prandaj refuzon atë t'a sistemojë në formë standardi institucional për t'i shërbyer qytetarit! Ose, këtu qëndron edhe problemi i demokracive tona kaq të thyshme, pikërisht në mosdijen(prandaj mosdashjen) e pushtetarit për të vendosur lirinë e qytetarit në një sistem të qëndrueshëm e stabil ku do sundonte ligji dhe e drejta. Prandaj revolucionet tona mbeten të pakrye të pakryme, ato vetiu pjellin revolucionin e ri, sa për të fshehur gjurmët e mistershme e të pandriçume të të vjetrit.

Ah, dhe ne vazhdojmë të pyetemi... po ne, ne që tani i dijmë të gjitha misteret e revolucionit por edhe motivet e pasrevolucionit, me ne çka do bëhet? Të paskemi fatin e Dantonit edhe ne?! ose t'a kryejme revolucionin!? Por, si kryeshka revolucionin???

Do thoj pa Robespjerin e pa Dantonin! Ndoshta pa ata që e bëjnë atë...

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

"Nutela" italiane dhe shpik(f)jet shqiptare!

Përbajtja e këtij shkrimi më përngjan si ajo meseleja e Faik bej Konicës, i cili në një ese të tij kishte llaforur këshillën dhënë një gazetari në lidhje me botimin e një gazete! Miku im i nderuar, besoj se të kujtohet reklama që i bëhet çokollatës së famshme italiane, "Nutela", ku, pos të tjerash, thuhet: "Çdo të bënim nëse nuk do të ishte Nutela!" Dikush u përgjigj: "Do ta shpiknim!" Italianët nuk kishin nevojë për shpikje. Po tekefundit, kush janë italianët..., a mos vallë ata "kanë diç më tepër" se ne shqiptarët! Paçka se ata kanë industrinë automobilistike, paçka se ata prodhojnë vetura të shtrenjta, paçka se ata shpikën "Fiatin", "Scuderia Ferrari-n" dhe të tjera kategori veturash luksoze. Edhe ne kemi "shpikjet" tona, edhe ne kemi bëmat tona të mëdha e të lavdishme, edhe ne kemi bëma heroizmi, ato të Adem Jasharit dhe bëmat e Mujit e të Halilit. Dhe ne, shpikëm çmos, shpikëm agallëkun tonë me nargjile dhe asnjëri nuk tha ç'lidhje ka nargjileja me shqiptarët, shpikëm dembelinë tonë anadollake dhe asnjëri, hiç fare nuk u habit nga kjo shpikje jona, ne shpikëm edhe përkthyesin tonë të "dashur" dhe lëre që asnjëri nuk e dyshoi zana-tin, por edhe nuk i shqyrtoi përkthimet e tij idiotike, ne shpikëm edhe qëndrimin tonë prej mendjemadhi dhe asnjëri nuk tha "ore, po ç'na duhet gjithë ky çallëm", ne shpikëm politikëbërjen tonë "që flet mbarë e prapë" dhe asnjëri nuk thotë "kjo politikëbërje qenkësh e gabuar", ne shpikëm edhe tolerancën tonë të tepruar dhe asnjëri nuk na sugjeroi se ajo duhet kuruar në aspektin frojdian, ne shpikëm makiavelizmin dhe kur e pyetën politikanin e moderuar shqiptar se ç'lidhje kishte italiani nga Firenca me jetën shoqërore, shtetërore dhe të brendshme të shqiptarëve, ai u përgjigj: "Qëllimi arsyeton mjetin"... ne shpikëm edhe vetëkritikën tonë, por asnjëri nuk tha "ajo nuk është e sinqertë", ne shpikëm "makijazhin" tonë politik, por jo edhe protagonistët që do të merren me "makijazh" dhe që do të mësojnë për "makijazh", ne shpikëm "turizmin tonë patriotik", por ama asnjëherë nuk e konceptuam si pasuri tonën kombëtare, ne shpikëm edhe atë nacionalizmin tonë të rremë, por ama asnjëherë nuk thamë se ai ishte një "zbulim" i gabuar, ne shpikëm rripin për daullet e kushtimit, por ama nuk gjetëm "kushtrimdhënësin", ne shpikëm veglën muzikore popullore me dy tela dhe asnjëri nuk tha se asaj vegle duhet



shtuar edhe një tel..., asnjëherë nuk u mor vesh se pse e shpikëm pusin e që nuk gjetëm ujin, ne shpikëm edhe budallain, të cilit i "lejuam" të hedhë gurin në lumë që mandej për ta gjetur atë u "sulën gjithë çunat e lagjes" së gocës së bukur, ne shpikëm edhe recetën se si përgatitet "hoshafi" prej kumbullash të thata!

E zbuluam ulërimën tonë dhe asnjëri nga fqinjët nuk na tha: "komshinj të nderuar, bëni kujdes, uleni paksa zërin!" Ne asnjëherë nuk parashtruam pyetjen se pse shpikëm "aksham pazarin" tonë, kur ajo nuk na hyn në punë, ne shpikëm urrejtnë tonë të tërbuar dhe asnjëri nuk parashtrroi pse-në!..., ne zbuluam "inatin tonë homerik" dhe asnjëri nuk tha se ç'lidhje paskësh Homeri me inatçorët e mëhallës së haxhi babës..., ne shpikëm fantazinë tonë të azdisur, por jo edhe çokollatën e italianëve, ne shpikëm edhe besën e burrit shqiptar, por ama asnjëherë nuk e mësuam me tamam domethënie e saj, ne zbuluam vetinë e të qenit i përsosur..., dhe çuditërisht kjo "përsosmëri e jona", nuk na shpiu asgjëkund. Ne shpikëm edhe analistin, por jo edhe shkallën e zhvillimit cilësor, gjegjësisht nivelin kulturor-ideologjik, politik, shkencor dhe artistik të tij. Dikur moti, kur shqiptarët i thanë jo, komunizmit, shpikën partinë e parë politike..., shpikën edhe lidhshimin, e shpikën edhe mitin për kryeparin..., më vonë shpikën edhe një tjetër parti me "urdhër dhe me porosi". Ne shpikëm edhe sharjet dedikuar rilindësve tanë..., i shamë rëndë se pse pjesa dërrmuese e tyre vepruan në Stanboll, Bukuresht, Amerikë e vende të tjera të dynjasë njerëzore. Ne shpikëm edhe sharjen dedikuar Gonxhes, pse ajo braktisi Shkupin për të ikur në Kalkutë. Ne ofenduem keq edhe Gjergjin, pse ai u

Sot e gjithë ditën e Perëndisë, ca shqiptarë folk-patriotë po edhe ca nacionalistë virtualë, të cilët sabah e aksham tymosin cigare prej Evropë e Amerikë, dhe të cilët shumë më mirë e njohin sintaksën sllave, sesa standardin e gjuhës shqipe, mëtojnë me pa të drejtë të shpikin fjalorin e lavdisë dedikuar njerëzve që kanë futur turinjtë në kazanin ku zihet uji i turbullt i..., dhe e gjithë kjo të bën të habitesh e të thuash se si mund të lavdërohet, po edhe të shpërblehet, njeriu që bën punë të pista!



shkollua në Akademinë ushtarake të Sulltanit..., do fyhet rëndë edhe për faktin se pranoi të quhet Isken-derbey..., ne shpikëm edhe ofendimin drejtuar nobelistit Ferid..., pse ai nuk erdhi në Shqipëri për të shpikur "Viagrën"... ne shpikjet tona më të reja do të vazhdojmë ta paragjykojmë edhe Kadarenë..., duke thënë "Ore, pse ky njeri mendjendritur, iku nga vendlindja e tij! Ne me shumë të drejtë shpikëm edhe hundën e provincialistit, i cili në vend se të ndërtojë mirësjelljen e tij dhe komunikimin e ndërsjellë me komunitetin që i takon, ai për fatkeqësinë tonë, ngrë hundën lart e më lart!

Miq të nderuar! Ne shpikëm edhe ndjenjën e inferioritetit tonë foshnjarak dhe askush nuk tha se

kjo cenon dhe denigron dinjitetin tonë! Kur jemi te nocioni inferioritet, neve do na jepet e drejta sa i përket shpjegimit të një meseleje shumë të vjetër dhe të vërtetë. Këtë shpjegim do ta bëjmë edhe përtej durimit a inatit tanë. Dikur moti ne shqiptarët e Republikës të Maqedonisë si dhe shqiptarët nga Kosova "zbuluam" tregun e pemëve dhe perimeve të Selanikut. Shkonim atje për të bërë pazare. Ne që nuk e flisnim gjuhën greke, ballafaqoheshim me telashe të shumta me tregtarët helenë në bërjen allishverishe..., dhe qëkur ne përfundimisht nuk merreshim vesh, detyroheshim t'ia kthenim në gjuhën serbe a maqedonase..., kinse greku do të na kuptojë..., kjo shpikje e inferioritetit, asokohe, kishte zënë vend diku në nënvetëdijen tonë kolektive dhe kundërthënëse. Sot e gjithë ditën e Perëndisë, ca shqiptarë folk-patriotë po edhe ca nacionalistë virtualë, të cilët sabah e aksham tymosin cigare prej Evropë e Amerikë, dhe të cilët shumë më mirë e njohin sintaksën sllave, sesa standardin e gjuhës shqipe, mëtojnë me pa të drejtë të shpikin fjalorin e lavdisë dedikuar njerëzve që kanë futur turinjtë në kazanin ku zihet uji i turbullt i..., dhe e gjithë kjo të bën të habitesh e të thuash se si mund të lavdërohet, po edhe të shpërblehet, njeriu që bën punë të pista! Mos vallë në këtë nënqiellin tonë (nuk) ka bir nëne, që do i bëjë zap gjullurdisë që na ka kapur për fyti e na ka nakatosur fiqirin. Përfundimisht, e gjithë kjo është punë shqiptari. Kthehu nga të kthehesh, shpinën e ke pas, thotë im vëlla! Miku im, unë nuk kam habere se çka nuk shpikën shqiptarët.

P.S. Këtë nga anët tona, nuk ka ndërmarrje industriale që prodhon çokollatën "Nutelë". Ka "uzina" ku shpikën ngatërresa e turbullira!

Nga
Fadil LUSHI





Përkitazi me premierën 'Vdekja e Dantonit' e autorit gjerman Georg Buchner, në regji të Dino Mustafiqit, realizuar nga Teatri Shqiptar i Shkupit.

PREMIERË

REVOLUCIONI I KEQKUPTUAR NGA BIJTË E TIJ

Koha Nga Emin AZEMI

Teatri Shqiptar i Shkupit të enjten (24 maj) shfaq premierën "Vdekja e Dantonit" e Georg Buchnerit, në regji të Dino Mustafiqit, një dramë nga epoka e romantizmit që trajton ngjarje të bujshme të Revolucionit borgjez francez. Kjo fabulë politike-sociale ka dimensionin e universalitetit hapësinor e kohor dhe si e tillë ajo mund të perceptohet edhe si pamflet artistik që reprodukon mimesisin e kohëve të mëvonshme, përfshi edhe kohën e sotme. Në thelb të intrigës fabulare është tragjika, por siç do të thoshte Karl Viëtor „tragjedia e Dantonit nuk ka të bëjë gjithaq me rënien e tij, sa me mënyrën se si bie, duke arritur që veprimi dramatik të zhvillohet ashtu që 'tensioni të bartet nga qëllimi/caku në mënyrën se si zhvillohet' (Volker Klotz). Një pjesë e publikut madje u idnetifikua emocionalisht me mbindërtimin dramaturgjik të kësaj shfaqje tek sa nxirrte herë pas herë reminishenca në formë protestash, parodish e akuzash të kohës së sotme, që ishin aluzione të hapura me situatën aktuale politike e sociale në vend.

Kjo vepër dramatike e Georg Buchnerit kishte provokuar regjisorë të shumtë në botë dhe llogaritë të jetë një prej pjesëve më të popullarizuara dhe më të realizuara nëpër teatrot e ndryshme metropolitane.

FABULA

Në planin e përgjithshme drama trajton raportin në mes të prijësve dhe tundimeve që ofron pushteti, kurse në mikro-plan detajizon paradokset e pasojave që sjell revolucioni në një shoqëri me kontradikta të pambyllura sociale e politike.

Përshtypja e parë që të ngelë pasi të përfundojë kjo shfaqje është leximi regjisorial që del të jetë tepër i rafinuar dhe planifikuar me detaje. Por, si në çdo projekt skenik, edhe këtu erdhi në shprehje bashkëpunimi perfekt në mes të regjisorit dhe ikipit të aktorëve. Suksesi të regjisë së Dino Mustafiqit gjithsesi i atribuohet edhe ky dell bashkëpunimi që u manifestua me



mjaft plasticitet në mizanskenat dhe në efektet përcjellëse optike e tonike. Ajo çka ngelë e sedimentuar pak më gjatë në kujtesën e publikut pasi ta ketë shikuar dramën "Vdekja e Dantonit" është elani motivues i aktorëve të Shkupit të cilët me lojën e tyre korrekte ofruan një produkt skenik që nënkuptohej si gdhendje e nyjeve të historisë me daltën e sporovuar të muzës teatrore, bashkëshoqëruar me priren për të portretizuar figura historike plot dramacitet nga revolucioni borgjez francez.

KARAKTERET/INTERPRETIMET

Zhorzh Zhak Dantoni (interpretuar nga Refet Abazi), një avokat që jetonte e punonte në Paris, me oratori të jashtëzakonshme, në vitin 1789 e nxiti dhe motivoi popullin në rrëzimin e Bastilës. Një vit më vonë, bashkë me miqtë e të prirë nga Kamij Demulën themeloi Klubin e Kordelëve, i cili kishte për synim të krijonte terren të përshtatshëm shoqëror për dominim mbi jakobinët. Pas rënies së Monarkisë bëhet ministër i Drejtësisë dhe fton qytetarët revolucionarë të shpartallojnë dyert e burgjeve të Parisit me qëllim të frikësimit të rojalistëve dhe të ngjeshje radhët e revolucionarëve. Aksioni politik i Dantonit vazhdon me zgjerimin e propagandës ndër masa, madje edhe jashtë shtetit, për të themeluar Tribunalin revolucionar, një gjykatë e autorizuar për të dënuar krimet po-

litike. Kurse, me sugjerim të tij, Robespieri (interpretuar nga Luran Ahmet) formon qeverinë revolucionare e quajtur Këshilli i shpëtimt publik. Në ndërkohë Dantoni ndihmon që të rrëzohen Zhirondinët, një grupim politik që nuk ishte koherent me kërkesat politike të kohës, të cilët refuzuan ofertën për një bashkëpunim më të ngusht. Mirëpo gjithë trajektorja e veprimit politik të Dantonit përshkohej me taktizime dhe maturi, që fatkëqsisht edhe nga një pjesë e mbshetësve u lexua si luhajtje, dhe kjo mjaftoi që të krijohen dyshime ndaj tij. Për ta penguar përshkallëzimin e mëtejme të revolcionit, del kundër radikalëve beritist, të cilët angazhoheshin që gjithë pushteti të kalojë te Komuna.

Pas fjalimit që pati Robespieri (25 dhjetor 1793), mbajtur në Konventë, në mbrojtje të politikave radikale revolucionare, tensioni në mes tij dhe Dantonit fillojnë të rriten, për t'u përshkallëzuar me arrestimin e këtij të fundit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Dantoni përfundon në gjyotinë, por me këtë nuk mbyllet kontradiktat që prodhon Revolucionin.

Interpretuar nga aktori i sporvuar dhe me identitet të qartë skenik, Dantoni i Refet Abazit, vjen në sytë e publikut me gjithë madhësinë e heroit që gjatë rrugëtimit të tij teston dhe sprovon vetveten kundrejt dilemave që sjell koha. Ai në fund pagoi me çmim të lartë

kontradiktat e të qenit natyrë homoduplekse: pak revolucionar, pak hedonist, pak taktizues dhe kjo tërësi komplekse karakterologjike u paketua me një 'inventar' finesash mizanskenike nga Refet Abazi, i cili dëshmoi se loja-aktrimi për të është 'gjaku' që e mban gjallë kredon e tij prej artisti dhe sikur na paralajmëron se rikthimi i tij në skenë do të shoqërohet me një grafikun ngritjeje-përkushtimi për teatrin. Refet Abazi bashkë, me Luran Ahmetin, arriti të jetë strumbullari i gjithë arkitekturës dramaturgjike dhe me spontanitet prej artistit të sprovuar ia arriti të kombinojë lojën me diskursin regjisorial, duke balancuar në momente të veçanta kompleksitetin e karakterit me jashtësinë plastike të mimikës dhe lëvizjeve.

Pobespieri (Maksimilian Fransa-Isidor) që erdhi i realizuar nga Luran Ahmeti, ishte një avokat, i cili më vonë bëhet kryetar i Klubit të Jakobinëve. Pas arratisjes së Luigjit XVI, bëhet kundërshtar i rreptit Monarkisë. Nga fundi i viteve nëntëdhjeta të shek. 18 ishte një nga njerëzit më popullor të Revolucionit dhe përfaqësues i zjarrtë i rrymës radikale të Montanjës. Po në këtë periudhë kohore rrëzon zhirondinët e matur dhe eberitët radikalë, kurse si cak përfundimtar kishte Dantonin dhe kordeljerët. Terrori i tij absolutist merr fuqi, inicon spastrime në Këshillin e shpëtimt publik, mirëpo kundërshtarët

e tij dalin më mizorë sepse ja arrijnë ta arrestojnë dhe ta ekzekutojnë në gjyotinë (detaje këto historike për të cilat nuk flet kjo dramë).

Ky është konteksti dhe shtrati historik në të cilën zhvillohet fabula e kësaj drame, ndonse dramaturgia (Zheljka Udoviçiq Pleshtina) dhe regjisorit (Dino Mustafiq) kanë marrë disa sequenca dokumentare nga kjo atmosferë me plotë turbulencia.

Luran Ahmeti na e dha një Robespieri të formatuar në linjat e karakterit të fortë, me një vizurë ku dominonin vijat e njeriut që është i gatshëm të sakifikojë gjithçka, madje edhe ish miqtë e tij (Dantoni), në favor të lavdisë që sjell pushteti absolutist. Robespieri i historisë dhe Robespieri i skenës erdhën në një pikëtakim mizanskenik në momentin kur Luran Ahmeti rumbullakoi tërësinë komplekse të ambicjeve e manireve të një njeriu që po përgatitej të zëvendësojë idhujt e monarkisë me fuqinë përfaqësuese të Republikës. Ky aktor po e pasuron karrierën e tij artstike me një qasje mjaft të zgjuar në përvetsimin e fshehtësive që ka arti skenik. Ndër ato fshehtësi ishte edhe Robespieri i Revolucionit francez, i cili gjeti një 'shtof' të përshtatshëm brenda botës së aktorit Luran Ahmeti.

Në galerinë e karaktereve që kishin kontekstualitetin e tyre tematik ishin edhe Kamij Demulën



ishte tema e tregimit Lenz. Büchneri nuk ishte identifikuar me asnjë rrymë a tendenc letrare të kohës së tij, përveç se në fillim paksa me 'Sturm und Drango' ('Stuhi dhe Thirrje') që ishte inicuar nga Cëte. Me vdekjen e hershme të Büchnerit, dramet e tij ishin kapluar nga inercioni i harresës, që erdhi pas ndryshimeve të mëdha të shek. 19, deri sa ato i ybuluan rishitazi nga shkrimtari gjerman i kohës së natyralizmit, Gerhart Hauptmann. Historianët e letërsisë në mënyra të ndryshme kanë interpretuar veprën e tij, vërsisht nga konteksti kohor dhe qasjet personale. Por shumica pajtohen se opusi dramatik i Büchnerit ishte shumë larg standardeeve të kohës dhe si të tilla ngelën gjithmonë me tematikë universale.

DIZAJNI MULTIFUNKSIONAL I SKENËS

Funksionaliteti skenik i dramës 'Vdekja e Dantonit' do të ishte i pamjaf-tueshëm sikur të mos gërshetohej një poetikë mjaft simbolike e skenografisë (Dragutin Broz), koreografisë (Gjergj Prevazi), kostumografisë (Ines Golja), (muzikës (Oliver Josifovski) dhe efekteve të multimedias (BETIM ZEQRIRI). Zhvillimi i gjithë ngjarjeve pranë një ure lëvizëse, përveç simbolikës së rënie/ngritjes së pushteteve e njerëzve, kishte edhe praktikitetin e vet. Në faturën regjisoriale të Dino Mustafiqit arritëm të shquajmë stilin e tij postmodern në kombinimin e elementeve përcjellëse të dizajnit skenik dhe arkitekturës dramaturgjike, e që u integruan natyrshëm në 'skenimin' paralel të atmosferës së kohës së tanishme, me idenë që revolucionet jan si ujërat nëntokësorë – dalin mbi sipërfaqe atëherë kur nuk e pret fare dhe fashiten kur e ke nevojën më së shumti. Përmbajtjet e ndajshuara të dramës së Georg Buchnerit, ridëshmojnë komponentën e universalitetit të saj, por edhe fuqinë e rrezatimit artistik pa e lënduar idenë baziketë aurorit.

Gjithsesi para nesh kemi një projekt të suksesshëm skenik, i cili mund ti shërbejë Teatrit Shqiptar të Shkupit dhe menaxhmentit të tij si provë e guximshme për të rikthyer famën e dikurshme të kësaj shtëpie, kurse 'Vdekja e Dantonit' mundet të jetë referencë kuptimplote artistike për skenat jashtë Maqedonisë, por pse jo edhe për festivale.

tojnë në skenë kanë probleme me artikulin dhe diksionin, shoqëruar me disa finesa fizike (dominojnë kryesisht vajza e çuna paksa të imtë) që gjithsesi çojnë peshë në fizionominë e përgjithshme të një ansambli teator, i cili duhet të ballafaqohet me lloj-lloj sfidash që imponon 'inventari' i karaktereve shpirtërore e fizike të personazheve.

I HARRUARI I KOHËS SË TIJ, GEORG BÜCHNERI

Për shkak të pikëpamjeve të tij radikale mbi politikën, Georg Büchneri ishte i detyruar ta lëshojë Gjermaninë dhe të vendoset në Zyrih, ku edhe heq dorë nga angazhimi në politikë. Këtu e ka burimin dioptria dëshpëruese e vrojtimit të botës nga ana e tij e që gjerësisht u manifestua në tri dramet ('Vdekja e Dantonit', 'Leonca dhe Lena' dhe posaçërisht te drama e fundit 'Woyzeck'. Përveç këtyre tri dramave, Büchneri, ka shkruar edhe një novelë mjaft introspektive, 'Lenc', si dhe një dramë që konsiderohet e humbur 'Pietro Aretino' kushtuar shkrimtarit venedikas me të njëjtin emër që i takonte renesancës së vonë.

Pavarësisht karrierës së shkurtër letrare (jetoi vetëm 23 vjet) autori Georg Büchneri ushtroi ndikim të fuqishëm në dramaturgjik dhe konsiderohet 'burim i pashtershëm i drams moderne'. Sa jetoi në Zürich, bëri edhe disa përpjekje të pasuksesshme që të punoj si pedagog në universitetin e atjeshëm. Sa i përket modeleve letrare dhe ndikimeve potenciale mbi të, duhet përmendur gjithsesi Shekspirin Gëten dhe Johan Michael Reinhold Lenz, rrëfimi jetësor i të cilit

(Fisnik Zeqiri), Lëzhandër/Barer (Muzbajdin Qamili), Lakrua (Osman Ahmeti), Zhuli (Amernis Nokshiqi) dhe ndonjë tjetër.

Fisnik Zeqiri kësaj radhe arriti të mbaj peshën e aktorit që din të zbërthejë psikologjinë e personazhit pa e deformuar spontanitetin e lojës dhe poetikën e lëvizjeve skenike.

Ndërkaq Musbajdin Qamili, edhe pse u paraqit në dy role, e mbajti gjatë gjithë kohës një linjë konstante të interpretimit mjaft virtuoz dhe ata që e kan ndjekë me vëmendje do të kenë ngelur të kënaqur me shkathtësinë e tij transformuese, një veti kjo e aktorëve që vënë në lëvizje dy e më shumë metoda aktrmi për të dëshmuar natyrshmërinë e karaktereve kontrastive brenda mizanskeneve të ndryshme.

Osman Ahmeti luajti një prej roleve të rëndësishme, e që ishte edhe hallkë që mbante balancet e arkitekturës dramaturgjike e përmbajtësore. Ai po vjen duke e dëshmuar potencialin e tij prej aktori ambicioz.

Në role tash më të sporovuara që arrijnë të transmetojnë gjithë plasticitetin e natyrës femërore, edhe kësaj radhe erdhi Armenis Nokshiqi, kurse karakteri që fiksohej brenda kësaj natyre njerëzore u realizua kënaqshëm skenikisht nga ajo.

Prurjet e reja të aktorëve debutues në këtë shfaqje, shumica prej të cilëve studentët të aktrimit, mund të jenë shpresa e Teatrit të Shkupit, ndonëse kjo nuk mjafton për të pretenduar dhe synuar një ekip më të formuar artistikisht. Jo pak prej të rinjve që po depu-



BOTIME TË VEÇANTA

Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974

Shtëpia botuese "Logos A" realizoi edhe një projekt të veçantë dhe mbi të gjitha të rëndësishëm jo vetëm për shqiptarët në Maqedoni, por edhe më gjerë. Bëhet fjalë për veprën voluminoze në gjashtë vëllime, me titull "Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974" të përgatitur nga historiani padyshim më produktiv, Qerim Lita, i cili bëri përzgjedhjen, redaktimin, përkthimin, duke shkruar edhe hyrjen dhe një parathënie mjaft koncize dhe sqaruese.

Mbi 450 dokumente bëjnë fjalë për QËNDRESËN ANTIKOMUNISTE, PROCESIN E SHPËRNGULJES, KËRKESAT E INTELIGJENCIES SHQIPTARE, DEMONSTRATAT E VITIT 1968, AVANCIMIN E STATUSIT dhe vëllimi i fundit për ARSIMIN, KULTURËN DHE RELIGJIONIN.

Dokumentet që botohen për herë të parë dëshmojnë për të vërtetën e pozitës së shqiptarëve në Maqedoni midis viteve 1944-1974, periudhë kjo që ishte me shumë të panjohura, por që me angazhimin e jashtëzakonshëm të historianit Lita, tash e tutje do të jetë e ndriçuar dhe e argumentuar me fakte konkrete.

Dokumentet pasqyrojnë ngjarje të shumta, pastaj aktivitetin e shumë personaliteteve, të cilët e luftuan si ideologjinë komuniste, ashtu edhe procesin e shpërnguljes drejt Turqisë. Mjaftë përmbajtjesore është sidomos vëllimi ku bëhet fjalë për demonstratat e vitit 1968 në Tetovë.

Lexuesi shqiptar për herë të parë do të ketë rastin të lexojë edhe për shumë probleme të shqiptarëve në arsim, kulturë dhe religjion, të cilat përshkohen me shumë informacione. Pra në këtë projekt voluminoz dalin në pah një mori ngjarjesh dhe një galeri e madhe e personazheve që i dhanë vullë, qoftë për të mirë qoftë për të keqe, çështjes shqiptare.

Në rrethana normale këtë angazhim të Qerim Litës dhe të Shtëpisë botuese "Logos A", e bëjnë institucionet shtetërore dhe ekipet e shumta, por në rrethanat tona ja që këtë përgjegjësi e merr një individ dhe një shtëpi botuese, të cilët i bashkuan potencialet e tyre, duke na sjellë një vepër shumë të rëndësishme për historinë e shqiptarëve në Maqedoni.

Vlen të theksohet edhe ana teknike e këtij kompleti, e cila është realizuar me një shije dhe cilësi të lartë, që këtë botim të jashtëzakonshëm e bëjnë edhe më të rëndësishëm. Padyshim se ky projekt gjatë vitit 2018 do të jetë ndër më të rëndësishmit jo vetëm në Maqedoni, por në të gjitha hapësirat shqiptare.

"Logos A" edhe me këtë projekt dëshmoi se është ndër shtëpitë botuese më serioze, e cila vit pas viti lexuesin shqiptar e befason me botime të veçanta dhe të jashtëzakonshme, siç është edhe ky i fundit, i titulluar "Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974".



Portreti krijues i Agim Vincës

Gjatë dyzet vjetëve të krijimtarisë letrare e shkencore Agim Vinca ka krijuar portretin e tij poetik, shkencor e intelektual, me një individualitet të dalluar. Ai i përket brezit të tretë letrar në letërsinë e sotme shqipe.

Në personalitetin krijues të Agim Vincës është shkruar bukur prirja poetike me prirjen shkencore. Tekefundit, të gjitha teoritë letrare janë krijuar nga përvoja artistike letrare. Profili i krijues të Agim Vincës e shquan triptiku poetik, historiografik dhe publicistik. Agim Vinca ka hyrë në poezinë shqipe me akuarelet sugjестive e reflektive të jugut.

Lirikat e tij janë dridhje të shpirtit, frymëzime të çiltra plot imazhe e vizione simbolike nga jeta, historia e mitologjia. Në lirikat e tij pulson ideali, dashuria, malli, revolta, qëndresa e ironia me freskinë e shprehjes poetike. Aty edhe thjeshtësia sublimohet në poezi.

Agim Vinca ka botuar deri sot gjashtë vëllime poetike: "Feniksi", 1972, "Bregu i mallit", 1975, "Buzëdrinas", 1981 e 1984, "Arna dhe ëndrra", 1987, "Kohë e keqe për lirikën", 1997, "Psalmet e rrënjës", 2007 dhe tri vëllime të përzgjedhura të poezisë: "Në vend të biografisë", 1977, "Dri", 1999 dhe "Sonet i vetmuar", 2001. Poezia e A. Vincës është vlerësuar bukur nga kritika letrare:

Rexhep Qosja: "Poezia e Agim Vincës ka edhe muzikë, edhe kuptim." Dritëro Agolli cilëson individualitetin e tij poetik: "Agim Vinca, kjo pemë e poezisë, mbetet më vete, pa hijen e të tjerëve." Xhezair Abazi: "Agim Vinca mbart intensitetin emocional përmes një vargu që i ngjan apo-teozës së madhe noliane."

Lirikat e Vincës tashmë ka zënë vend në antologji të poezisë shqipe, duke hyrë edhe në ato të përkthyer anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, turqisht, arabisht, rumanisht, sllavisht etj. Këtu vlen të theksohen: Robert Elsie, "Antologji e poezisë moderne shqipe", 1993, Aleksandër Zoto, "Antologji e poezisë shqipe prej fillimeve deri sot", 1997, Certruda Ejlntrej, "Antologji e letërsisë shqipe".

Edhe Agim Vinca ka botuar antologjitë "Nga poezia bashkëkohore shqipe...", Sarajevë, 1985 dhe "Kënga e hapur", 2005, antologji e parë me perla poetike shqipe, të shoqëruara me vlerësime kritike.

Po ashtu, ai ka përzgjedhur për botim poezitë e Ndoc Papekës, Koçi Petritit etj.

Agim Vinca konsiderohet sot ndër njohësit e studiuesit më të shquar të poezisë moderne shqipe.

Kritikat dhe studimet e tij letrare, me analiza e sinteza historike, i shquan akribia shkencore dhe qartësia e komunikimit.

Deri sot ka botuar veprat me kritika e studime letrare: "Aspekte të kritikës sonë", 1977, "Qasje", 1980, "Orët e poezisë", 1990 dhe "Fije të pakëputura", 2004, studimet letrare "Struktura e zhvillit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)", 1985, "Alternativa letrare shqiptare", 1995 dhe "Panteoni i ideve letrare (prej antikës deri te postmodernizmi)", 2002.

Akademik Rexhep Qosja ka vlerësuar monografinë e A. Vincës për strukturën metriko-ritmike, semantiko-figurative e tipologjike të poezisë moderne shqipe: histori e vërtetë e poezisë bashkëkohore shqipe dhe, madje, si një histori e thelluar e kësaj poezie.

Vepra e Agim Vincës është shprehje e vetëdijes më të lartë kritike dhe historiko-letrare. Në fushën e kritikës dhe të studimeve letrare A. Vinca ka trajtuar nocione kritike e teorike të poetikave të ndryshme, fenomeneve letrare dhe vepra të veçanta të poezisë e të prozës nga tradita dhe moderniteti. Këtu shquhen studimi "Mendimi kritik i Mitrush Kutelit" dhe ato për disidencën letrare të Lame Kodrës, Kasëm Trebeshinës, Petro Markos etj.

Agim Vinca e ka trajtuar gjithëherë letërsinë shqipe si një dhe të pandarë, pavarësisht nga kufijtë politikë.

Prof. Abdyl KADOLLI



AGIM VINCA

GLOSË PËR ÇAMËRINË

Ne shumë pak kemi kënduar për Ty!

(Jo pse s'të kemi dashur, jo pse s'të kemi njohur).

Pak kemi kënduar...

Po në zemër një vend gjithmonë e kemi ruajtur për Ty;

një vend bosh, e dashur,

Çamëri!

KËNGË STRUGANE

Ti dhe lundra lëvorashe

të dyja me hapa vashe

Ti dhe ky gjoli mavi

keni po të njëjtit sy

Ti dhe e bukura valë

më flisni të njëjtat fjalë.

PSALM PËR SHËN NAUMIN

Je tepër i bukur

për të qenë i vërtetë

E tepër mëkatar

për të qenë i shenjtë

Një mallkim i kaltër

ç'po të fle në sy

I mjeri unë për ty!

PARADOKS

Kur fola, më thanë: hesht!

Kur heshta më thanë: fol!

Folehesht, heshtefol qe jeta ime.

TROKITJE

Tearca, Tanusha, Tetova

Trandshëm trokasin te porta.

Njerëz, vini dorën në zemër

Zemra fillon tek aorta!

POETI ME KONE

(Për Lasgushin dhe qenin e tij)

Mesditë gushti. Verë. Vapë e zagushi...

Te café-bar Relax me veten time rri.

Rrufis kafenë ekspres e cigaren thith

Në ajrin e vakët një pulëbardhë klith.

Bën vapë, Lasgush, vapë e zagushi

Te café-bar Relax kuvendoj me ty...

Dhe ti si unë dikur andej matanë,

Veç konës sate — askënd pranë.

Më të flisje, me të qeshje e qaje...

Thonë se dhe shtratin me të e ndaje.

Përballë kam Esenin, kaçurrelin bjond,

Që qenin e Kaçallovit e qau me lot...

Janë të marrë poetët dëgjon të thonë shpesh

E ndodh dhe t'i gërgasin ca laro e syleshë...

Po sakaq ndër mend një mendim më vjen:

«Më mirë një qen mik sesa një mik qen!»

Mesditë gushti. Verë. Zhurmë e vetmi.

Te café-bar Relax me veten time rri ...

(Strugë, 2016)

Made in Prishtinë

QYTETI FLE NË ZJARR E ETHE

Bie e ngrihet në kllapi.

Një hënë e zbehtë rend ndër gjethe

Një hënë si pika përmbi i.

Tri herë në ditë ding-dang kambana

la pret hoxha në minare:

Ruana Zot! Allah, Allah

Nga djalli që na qiti fare!

E kush është djalli askush s'e di

Kush është shejtan a pejkamber

Hëna baret përmbi çati

Droja troket derë më derë.

Dremit qyteti e njerëzia

S'i heqin sytë nga ekrani.

Vjen shpëtimtari nga Velania,

Vjen dhe mesia nga Dragodani.

Tri herë në ditë ding-dang kambana

Allahu ekber! — lart në minare:

Ruana Zot e Jehova

Nga djalli që na qiti fare!

E kush është djalli askush s'e di

Kush është mesi e pejkamber

Shtatë protektorë, dyqind parti

Trokasin fort derë më derë.

Hape! — thotë njëri. Hape! — dhe tjetri.

Jam Jezu Krishti, Juda, Shën Pjetri.

Jam Shën Mëria, Parajsa vetë.

Zoti, Mesia, Baba dovlet.

Qyteti ka ethe, afsh e zjarrmi.

Hëna ndër gjethe si pika mbi i

ÇDO DITË E MË PAK SHQIPTARË

Kalimi nga një normë mesatare të fertilitetit prej mbi pesë fëmijë për grua nën normën e zëvendësimit të popullsisë mori dy shekuj në Francë, por vetëm 34 vjet në Shqipëri, thotë Banka e Botërore në një studim të posaçëm për efektet që ka moshimi i popullsisë në zhvillimin ekonomik afatgjatë



Në shumë vende, rënia e lindshmërisë ka qenë dramatike dhe e shpejtë. Kalimi nga një normë mesatare të fertilitetit prej mbi pesë fëmijë për grua nën normën e zëvendësimit të popullsisë mori dy shekuj në Francë, por vetëm 34 vjet në Shqipëri, thotë Banka e Botërore në një studim të posaçëm për efektet që ka moshimi i popullsisë në zhvillimin ekonomik afatgjatë. Norma totale e fertilitetit (TFR) ka rënë në shumë vende të rajonit, po ashtu edhe në Shqipëri, poshtë 2.1 fëmijë për grua, që është norma e zëvendësimit të nevojshme për të mbajtur popullatat në nivelet aktuale, pa marrë në konsideratë emigracionin.

Shqipëria e pati këtë normë 1.5 fëmijë për grua në vitin 2016. Ulja drastike e normës së lindjeve po "tremb" të gjithë parashikuesit. Emigracioni luan rol të rëndësi-

shëm në balancimin e moshës së plakjes, duke konsideruar që pjesa më e madhe e emigrantëve janë të rinj (mesatarisht). Por, kjo nuk ndodh me vendin tonë, ne nuk jemi vend "pritis" i emigrantëve, përkundrazi, popullsia jonë është reduktuar për shkak të këtij fenomeni. Rritja e moshës së plakjes rrit shpenzimet për pensione dhe kujdes mjekësor.

Sipas këtij raporti, shpenzimet e kujdesit shëndetësor kanë të ngjarë të rriten më shpejt me përmirësimin e teknologjisë mjekësore, që do të sjellë rritje kostosh. Ndërsa koha dhe intensiteti i fertilitetit ndryshon, në shumë vende rënia ka qenë dramatike dhe ka ndodhur me shpejtësi. Për shembull, kalimi nga një normë mesatare të fertilitetit prej mbi pesë fëmijë për grua në poshtë normës së zëvendësimit të popullsisë mori

dy shekuj në Francë, por vetëm 34 vjet në Shqipëri, cilëson Banka Botërore. Norma mesatare e fertilitetit për grua në vendet e Azisë Qendrore ishte gjashtë fëmijë, në fillim të viteve 1960, por është më pak se tre fëmijë sot.

Rënia nga viti 1990 ka qenë veçanërisht e mprehtë në vendet e Azisë Qendrore dhe Turqi, të cilat kishin normat më të larta të pjellorisë në fillim të viteve 1970. Normat e fertilitetit në Kaukaz-Armeni, Azerbajxhan dhe Gjeorgji - tani janë të gjithë nën nivelet e zëvendësimit. Fertiliteti ka vazhduar të bjerë në mënyrë të konsiderueshme në Armeni, Taxhikistan, Turkmenistan edhe gjatë dekadës së kaluar përmirësim ka ndodhur në Kazakistan dhe në Republikën e Kirgistanit dhe, në një masë më të vogël, në Federatën Ruse, Ukrainë dhe Uzbekistan. Në

përgjithësi, megjithatë, vendet e Azisë Qendrore kanë ende norma relativisht të larta të pjellorisë që tejkalojnë normat e zëvendësimit të popullsisë. Disa vende në Evropën Qendrore, vendet e Lindjes dhe Rusia përjetuan një rritje të fertilitetit (a baby boom) pas Luftës së Dytë Botërore. Një numër shtetesh nuk ka përjetuar një bum fëmijësh. Shtetet baltike kishin normat më të ulëta të pjellorisë në botë në vitet 1950 dhe 1960. Bumi i lindjeve në këto vende ka ndodhur në vitet 1970 dhe 1980. Rënia e frikshme

Në vitin 1990, kur ekonomia shqiptare preku ekonominë e tregut pas 45 vitesh izolim, numri i lindjeve ishte mbi 82 mijë bebe në një vit. Por pas 25 vitesh me ngjarje eksodi masiv të shqiptarëve jashtë vendit, lindjet pësuan rënie drastike me 60% më 2015.

Duke parë trendin historik të lindjeve që nga vitet 1991 shihet një lidhje e qartë me emigracionin. Lindshmëria ra sistematikisht në vitet 1992, 1993 dhe 1994, e ndikuara nga vala e parë e emigracionit. Deri në vitin 1996, ishin larguar nga vendi mbi 600 mijë shqiptarë. Viti i mbrapshtë 1997 shënoi eksodin e dytë më të madh të shqiptarëve, me mbi 100 mijë të larguar nga vendi në një vit. Hemorragjia do të vijonte edhe në vitet e mëvonshme, duke ndikuar negativisht te lindshmëria deri në vitet 2009. Më pas, thuajse për pesë vite rresht, pati stabilizim të emigracionit dhe gjithashtu lindjet ndaluan rënien dhe nisën të rriten deri në vitin 2015.

Por fenomeni i lindshmërisë së ulët është rikthyer frikshëm në dy vitet e fundit, sidomos në gjatshëmujorin e parë të këtij viti, duke shënuar rënie me 22%, në raport me 6mujorin e parë 2017, më e larta në të gjitha vitet e tranzicionit. Edhe në raport me 6mujorin e dytë 2017, rënia ka qenë me ritme katastrofike, prej 28.9%. Nëse vazhdohet me këto ritme rënie, shifrat do të rezultojnë katastrofike. Që nga viti 1960, indeksi sintetik i fekondimit (numri i lindjeve për një grua) ka pësuar rënie të vazhdueshme. Ky indeks, në vitin 1960, ishte mjaft i lartë, më shumë se 5 fëmijë për një grua të grupmohës riprodhuese, ndërkohë që në vitin 2015, ky indeks është ulur në 1.78 fëmijë për një grua dhe së fundmi është 1.6. Moshja mesatare e popullsisë banuese është rritur nga 30,6 vjeç në 2001 në 36,6 vjeç në vitin 2016.

NË BOTË, 2 MILIARD PERSONA KONSUMOJNË UJË TË NDOTUR

Maria Neira në një deklaratë është shprehur se sot, pothuajse dy miliardë njerëz përdorin një burim uji të pijshëm të ndotur me feçe, duke i vënë ata përballë rrezikut të kolerës, dizenterisë, tifoidit dhe poliomielitit

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) ka njoftuar se pothuajse 2 miliardë njerëz në botë nuk mund të gjejnë ujë të pijshëm. OBSh në një raport, për analizimin dhe vlerësimin global të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve të ujit për vitin 2017, thekson se nuk janë kryer përpjekje të mjaftueshme për të arritur objektivat për ujin dhe kanalizimet në kuadër të qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të pranuar në OKB në vitin 2015. Drejtoresha e Departamentit të Shëndetit Publik në OBSh, Maria Neira në një deklaratë është shprehur se sot, pothuajse dy miliardë njerëz përdorin një burim uji të pijshëm të ndotur me feçe, duke i vënë ata përballë rrezikut të kolerës, dizenterisë, tifoidit dhe poliomielitit.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) ka njoftuar se pothuajse 2 miliardë njerëz në botë nuk mund të gjejnë ujë të pijshëm. OBSh në një raport, për analizimin dhe vlerësimin global të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve të ujit për vitin 2017, thekson se nuk janë kryer përpjekje të mjaftueshme për të arritur objektivat për ujin dhe kanalizimet në kuadër të qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të pranuar në OKB në vitin 2015. Drejtoresha e Departamentit të Shëndetit Publik në OBSh, Maria Neira në një deklaratë është shprehur se sot, pothuajse dy miliardë njerëz përdorin një burim uji të pijshëm të ndotur me feçe, duke i vënë ata përballë rrezikut të kolerës, dizenterisë, tifoidit dhe poliomielitit.

Në një hulumtim të publikuar vitin e kaluar në revistën "Science Advances" ishte vënë në dukje se 4 miliardë njerëz në të gjithë botën kryesisht në Kinë dhe Indi kanë probleme me ujin e pijshëm të paktën për një muaj në vit. Në një

ndodhen nën objektivin e përcaktuar në nivel kombëtar për shërbimet e WASH. Ndërsa Guy Ryder, drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) është shprehur se "kjo është një sfidë që kemi aftësinë për ta zgjidhur. Rritja e investimeve në ujë dhe kanalizime mund të sjellë përfitime të konsiderueshme për shëndetin dhe zhvillimin njerëzor".

Në një hulumtim të publikuar vitin e kaluar në revistën "Science Advances" ishte vënë në dukje se 4 miliardë njerëz në të gjithë botën kryesisht në Kinë dhe Indi kanë probleme me ujin e pijshëm të paktën për një muaj në vit. Në një



raport të përgatitur për 2.103 burime të ujit nga Ministria e Burimeve të Ujit të Kinës theksohet se 33 për qind e burimeve të ujërave janë të përshtatshëm dhe vetëm për përdorimin në fushën e industrisë, ndërsa pjesa tjetër prej 47

për qind është ujë jo i pijshëm. Gjithashtu ishte theksuar se një i pijshëm i përdorur në qytet sigurohet nga burime të sigurta dhe se nuk bëhet fjalë për ndonjë situatë që kërcënon shëndetin e popullatës.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 62/2018

për punësimin e 5 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Mbrojtjes” për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B02000 Udhëheqës i sektorit për logjistikë 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkenca ekonomike ose juridike
 - më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - punë me të tjerë/punë ekipore
 - ndërgjegjësime strategjike
 - orientim kah palët/palët e interesuara
 - udhëheqje dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e martë
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 35.813,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.
2. UPR0101B02000 Udhëheqës i sektorit për bashkëpunimin civil - ushtarak me 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat shoqërore, fakulteti ekonomik ose mbrojtje
 - më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - punë me të tjerë/punë ekipore
 - ndërgjegjësime strategjike
 - orientim kah palët/palët e interesuara
 - udhëheqje dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e martë
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 35.813,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.
3. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësies për patundshmëri, Sektori për patundshmëri 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat tekniko - teknologjike ose shkencat natyrore - matematikore
 - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - punë me të tjerë/punë ekipore
 - ndërgjegjësime strategjike
 - orientim kah palët/palët e interesuara
 - udhëheqje dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e martë
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 20.643,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
4. UPR0101V01000 Këshilltar për zbatimin e protokollit, Njësia për mbështetje 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, shkencat shoqërore
 - së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - puna me të tjerë/puna ekipore
 - ndërgjegjësime strategjike
 - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e martë
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 28.095,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
5. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për trajnim dhe planifikim të kapaciteteve në 1 realizues(ë)
- politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të BE - së, Njësia për sigurim të përbashkët dhe politikë të mbrojtjes, Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat shoqërore
 - me ose pa përvojë pune
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - puna me të tjerë/puna ekipore
 - ndërgjegjësime strategjike
 - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e martë
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 20.643,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
6. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.
- Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.
- Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.
- Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.
- Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.
- Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.
- Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Koçan, duke vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/2014, 199/2014, 27/16) dhe nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/05, 106/08, 161/08, 130/09, 120/11, 10/12, 11/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 34/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 74/15, 129/15, 27/16) publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 04-543/2 Për punësim të 4 (katër) realizuesve për kohë të pacaktuar

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan ka nevojë për punësim për kohë të pacaktuar të 4 (katër) realizuesve.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Koçan:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive të shfrytëzohj gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

1. Punëtor profesional – Logoped në Departamentin – Qendra ditore për persona me pengesa mentale ose trupore pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan – SOZ0303A05010-1(një realizues)

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan:

- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla VII/1 të përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK, Fakulteti filozofik, drejtimi Logopedi
- Të kenë dy vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale
- Në mënyrë aktive të njohin programet kompjuterike për punë në zyrë

Kandidatët e interesuar duhet të parashtojnë **Fletëparaqitje**, të bashkëngjitur dokumentacionin e nevojshëm, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter:

- Biografi të shkurtë
- Letër motivimi
- Diplomë (certifikatë) për shkallë të mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës
- Dëshmi (vërtetim) për përvojën punës në sferën e mbrojtjes sociale
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Vërtetim për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë,
- Certifikatë të mjekut për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Certifikatë të shtetësisë.
- Shumë mujore të neto pagesës: 23.198,00 denarë
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë, orari i punës: në mënyrë fleksibile me fillim prej ora 7:30 deri në ora 08:30 dhe përfundim prej ora 15:30 deri në ora 16:30.

Me kandidatin e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

2. Punëtor profesional – Psikolog në Departamentin - Qendra ditore për persona me pengesa mentale ose trupore pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan - SOZ0303A05004-1(një realizues)

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan:

- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla VII/1 të përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK, Fakulteti filozofik, drejtimi Psikologji
- Të kenë dy vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale
- Në mënyrë aktive të njohin programet kompjuterike për punë në zyrë.

Kandidatët e interesuar duhet të parashtojnë **Fletëparaqitje**, të bashkëngjitur dokumentacionin e nevojshëm, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter:

- Biografi të shkurtë
- Letër motivimi
- Diplomë (certifikatë) për shkallë të mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës
- Dëshmi (vërtetim) për përvojën punës në sferën e mbrojtjes sociale
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Vërtetim për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Certifikatë të mjekut për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Certifikatë të shtetësisë.
- Shumë mujore të neto pagesës: 23.198,00 denarë
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë, orari i punës: në mënyrë fleksibile me fillim prej ora 7:30 deri në ora 08:30 dhe përfundim prej ora 15:30 deri në ora 16:30.

Me kandidatin e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

3. Punëtor ndihmës profesional – Përkëdhelës në Departamentin -- Qendra ditore për persona me pengesa mentale ose trupore pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan - SOZ0303B03001-1(një realizues)

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan:

- Të kenë të mbaruar arsimin e mesëm, së paku niveli i kualifikimeve III, 180 kredi, sipas ECVET ose arsim të mesëm trevjeçar,
- Licencë për përkëdhelës

Kandidatët e interesuar duhet të parashtojnë **Fletëparaqitje**, të bashkëngjitur dokumentacionin e nevojshëm, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter:

- Biografi të shkurtë
- Letër motivimi
- Diplomë (certifikatë) për shkallë të mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Certifikatë të mjekut për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Certifikatë të shtetësisë.
- Shumë mujore të neto pagesës: 12.380,00 denarë
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë, orari i punës: në mënyrë fleksibile me fillim prej ora 7:30 deri në ora 08:30 dhe përfundim prej ora 15:30 deri në ora 16:30.

Me kandidatin e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

4. Punëtor profesional – Punëtor i diplomuar social në Shërbimin për shërbime të mbrojtjes sociale pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan - SOZ0303A06001-1(një realizues)

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan:

- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla VII/1 të përgatitjes profesionale ose 180 kredi sipas SETK, Fakulteti filozofik, drejtimi Punë sociale dhe politike sociale, pa përvojë pune
- Në mënyrë aktive të njohin programet kompjuterike për punë në zyrë

Kandidatët e interesuar duhet të parashtojnë **Fletëparaqitje**, të bashkëngjitur dokumentacionin e nevojshëm, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter:

- Biografi të shkurtë
- Letër motivimi
- Diplomë (certifikatë) për shkallë të mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Vërtetim për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë

- Certifikatë të mjekut për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Certifikatë të shtetësisë.

- Shumë mujore të neto pagesës: 23.198,00 denarë
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë, orari i punës: në mënyrë fleksibile me fillim prej ora 7:30 deri në ora 08:30 dhe përfundim prej ora 15:30 deri në ora 16:30.

Me kandidatin e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Afati për parashtimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke llogaritur nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes. Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitjen së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet ta parashtojnë në arkivin e IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan ose përmes postës në adresën në vijim:

rr. "Goce Dellçev" pn, Koçan
(me shenjë për shpallje nr. 04-543/2)
Personi për kontakt: U. D Drejtor Sonja Andonovska
Kontakt telefoni: 072-243-779

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Koçan
U. D Drejtor
Sonja Andonovska



Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit të punësimit në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 Ligjit të marrëdhënieve të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, boton

SHPALLJE

I. Për nevojat e themelimit të marrëdhënieve të punës për kohë të caktuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, për vendet e punës siç vijojnë:

1. Shef i qendrës së punësimit në Negotinë – 1 realizues

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet siç vijojnë:

- arsimin e lartë, përkatësisht më së paku 240 kredi të fituara në bazë të EKTS-së ose mbarimin e shkallës VIII/1
- më së paku katër vjet përvojë pune në profesionin në të cilin më së paku një vit në vendin e punës në sektorin publik, përkatësisht më së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesionin në të cilin më së paku dy vjet në vendin e punës si udhëheqës në sektorin privat;
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- vërtetim për provim më të ndërlikuar për drejtim administrativ;
- njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve më të përdorura në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- rroga bazë neto në vendin e punës do të jetë 28.200 denarë.

2. Referent për shërbime sportelike në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në qytetin e Shkupit – (2) dy realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Të ketë arsim të lartë ose të mesëm
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 14.900,00 denarë

II. Marrëdhënie e punës themelohet me orar të plotë pune – 40 orë në javë, prej të hënës deri të premten, ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 – 15:30

III. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dëshmi me të cilat vërtetohen kushtet e plotësuar.

IV. Shpallja zgjat pesë ditë pune nga dita e botimit të saj në shtypin e përditshëm.

V. Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në arkiv ose nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë – Shërbimi qendror, rr. "Vasil Gjorgov", nr. 43 Shkup.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato që nuk dorëzohen brenda afatit, nuk do të merren në shqyrtim.

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit për kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 187/2013, 44/2014, 61/2015, 154/2015, 39/2016 dhe 11/2018), Ministria e kulturës publikon:

SHPALLJE PUBLIKE Për zgjedhje të drejtorit të Institutit nacional – Filarmonia e Maqedonisë – Shkup

I

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për kulturë edhe atë:

1. Shtetas të Republikës së Maqedonisë;
2. Në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion penal, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
3. Ka të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 të arsimit sipëror të përcaktuar me statutin e institucionit;
4. Ka minimum pesë vjet stazh pune në sferën e kulturës ose pesë vjet përvojë pune në punë ose projekte në sferën e kulturës në bazë të marrëveshjeve të lidhura për vepër;
5. Ka një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT – së paku 74 pikë,
 - IELTS – së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
 - BULATS – së paku 60 pikë ose
 - APTIS – së paku niveli B2.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Statutin e institucionit:

1. Ka të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 të arsimit sipëror: fakulteti për art muzikor ose fakulteti nga sfera e shkencave shoqërore;

II

Kandidatët për zgjedhje të drejtorit të institucionit duhet të dorëzojnë edhe Program të tyre për punë dhe për zhvillim të institucionit, si strategji për periudhën e ardhshme katër vjeçare (2018-2022), në pajtim me Ligjin për kulturë, si dhe dokumentet në vijim (origjinal ose kopje të vërtetuar tek noteri):

- fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
- dëshmi për së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 të arsimit sipëror: fakulteti për art muzikor ose fakulteti nga sfera e shkencave shoqërore;
- dëshmi për minimum pesë vjet stazh pune në sferën e kulturës ose pesë vjet përvojë pune në punë ose projekte në sferën e kulturës në bazë të marrëveshjeve të lidhura për vepër;
- certifikatë të shtetësisë;
- vërtetim se nuk ka ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmi për një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT – së paku 74 pikë,
- IELTS – së paku 6 pikë,
- ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
- FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
- BULATS – së paku 60 pikë ose
- APTIS – së paku niveli B2

III

Drejtori i cili do të emërohet në periudhën nga dita e futjes në fuqi e Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/2018) deri më 1 shtator 2018, obligohet të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti prej ditës së emërimit të tij dhe të parashtojë dëshminë nga alineja 6 e pjesës së II të shpalljes së publikuar deri te Ministria e kulturës së Republikës së Maqedonisë. Drejtorit të cilit nuk do të përmbushë kushtin e njohjes së gjuhës së huaj në afatin e caktuar nga paragrafi 1 i kësaj pjesë dhe nuk do të parashtojë dëshminë e kërkuar deri te Ministria e kulturës i ndërpritet mandati.

IV

Shpallja zgjat 15 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet së bashku me Programin dhe dokumentacionin tjetër duhet të dorëzohen në Ministrinë e kulturës përmes postës në adresën: rr. "Gjuro Gjakoviq" nr. 61 – Shkup ose në Arkivin e Ministrisë së kulturës, më së voni deri në ora 16,30 ditën e fundit të shpalljes.

Materialet e dorëzuara në shpallje nuk kthehen.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk merren parasysh.

Për rezultatet e shpalljes kandidatët do të informohen me shkrim.

AUTONOMIA POLITIK-TERRITORIALE E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI (1)

SITUATA POLITIKE NË RS TË MAQEDONISË DERI NË SHPALLJEN E AUTONOMISË



Nga Qerim LITA

Rënia e regjimit komunist, te shqiptarët, ngjashëm sikurse edhe te një pjesë e popujve të ish federatës komuniste jugosllave: kroatët, sllovenët dhe boshnjakët u përjetua si një "çlirim kombëtar". Në zgjedhjet e para të cilat në RS të Maqedonisë u mbajtën gjatë muajve nëntor-dhjetor 1990, shqiptarët, të cilët përbënin 1/3 e popullsisë u rreshtuan në dy partitë e atëhershme politike: Partia për Prosperitet Demokratik - PPD dhe Partia Demokratike Popullore - PDP, të cilat arritën të fitojnë 23 ulëse në parlament (17 PPD-ë, 1 PDP dhe 5 koalicioni PPD-PDP). Me konstituimin e Parlamentit të parë pluralist e më pas edhe me formimin e të ashtuquajturës qeveri të "ekspertëve", çështjet jo që nuk ndryshuan në të mirë të shqiptarëve (të cilët thuajse për 10 vite me radhë (1981-1991) qenë skajshmërisht të diskriminuar si në pikëpamjen nacionale, ku me Amendamentin Kushtetues 56 të vitit 1989 u shpallën pakicë nacionale, po ashtu edhe në atë arsimore, kulturore, ekonomike etj.), por të njëjtat morën një kahje skajshmërisht antishqiptare, të cilat nxiteshin e mbështeteshin nga drejtuesit e atëhershëm politik e ekzekutiv maqedonas. Në këto rrethana, gjatë pranverës së vitit 1991, në disa vendbanime shqiptare u organizuan tubime, në të cilat u shtruan një sërë kërkesash, drejtuar Kuvendit të RS të Maqedonisë si dhe qeverisë së saj, disa prej të cilave po i paraqesim në vazhdim:

- sa më parë të hapen shkollat e arsimimit të mesëm duke filluar nga viti i ardhshëm shkollor 1991/92, të cilat shkolla qenë mbyllur para disa viteve nga mbeturinat e njëmendësisë e burokratike të sistemin monist, të cilët edhe sot e kësaj dite janë në pushtet;

- hapja e fakulteteve me mesim në gjuhën shqipe në dy universitetet ekzistuese në RS të Maqedonisë;

- të merret në përgjegjësi Savo Klimovskit nga fakti se ka kryer shkelje flagrante ndaj arsimit shqiptar, si ideolog i mbylljes së shkollave shqipe të garantuara me ligjet dhe Kushtetutën në fuqi të



Deklarata Politike e PDP-së nxiti qarqet e atëhershme shoviniste maqedonase, të involvuar brenda të ashtuquajturës "qeveri të ekspertëve" (në të cilën pa dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve, merrnin pjesë edhe tre shqiptarë), të ndërmarrin masa ndëshkuese kundër popullsisë shqiptare në përgjithësi, e të aktivistëve të kësaj partie në veçanti. Ministria për Informim përmes një komunikatë të lëshuar më 27 qershor, Deklaratën e PDP-së, e kualifikoi si një "pamflet" që çon, siç thuhet "kah destabilizimi i Republikës, kah cenimi i marrëdhënieve ndërnacionale..."

RSFJ-së;

- të lirohen të gjithë të burgosurit për shkak delikteve politike, të dënuar e të cilët dënimin e vuajnë si bastion e të burgosurve në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi.

- RS e Maqedonisë të jetë shtet sovran i të gjitha kombeve të cilët jetojnë në të e njëherit edhe i kombit shqiptar si sovran i atij shteti.

- në ata komuna ku jetojnë shqiptarët, gjuha shqipe të trajtohet në mënyrë të barabartë sikurse edhe gjuha maqedonase përkatë-

sisht në këtë komuna të dy gjuhët të përdoren si shtetërore pa majorizimin e njëjës apo tjetrës.

- RTV i Shkupit, përkatësisht Televizioni i Maqedonisë një kanal të programit ta ketë në gjuhën shqipe;

- në Kuvendin e RS të Maqedonisë për çështje me rëndësi siç janë: të drejtat e kombeve (arsimi, kultura, simbolet, flamuri, gjuha, toponimet, emërtimi i fëmijëve të porsalindur sipas dëshirës së prindërve të tyre etj.) të zgjidhet

me konsensus e jo me mbivotim e majorizim në të kundërtën nuk do të pranojmë asnjë akt të cilin do ta sjell Kuvendi... etj..

Kërkesat e shtruar në mënyrë publike nga shqiptarët, jo që nuk u përfillën, por madje udhëheqja politike e Maqedonisë, gjatë asaj periudhe kohore bëri përpjekje maksimale, të maqedonizohen të gjitha institucionet e atëhershme shtetërore, veçmas ato informative e kulturore si për shembull RTV i Shkupit u emërtua në RTV maqe-

donase, Filarmonia e Maqedonisë në Filarmonia maqedonase, Opera dhe Baleti i Maqedonisë në Opera dhe Baleti maqedonas etj.. Madje disa udhëheqës të lartë të atëhershëm shtetëror të RSM-së, shkuan deri atje saqë për shqiptarët, shpikën termin tepër ofendues "maqedonas me prejardhje shqiptare".

Se në cilat përmasa kishte shkuar shovinizmi maqedonas asaj kohe, më së miri mund ta shohim në dokumentin me titull: "Libri i Peticionit", i hartuar më 26 shkurt të vitit 1991 nga pesë bashkësitë lokale të fshatrave të komunës së Gostivarit: Gallatë, Zuboc, Pozharan, Tumçevisht dhe Vrapçisht. Ashtu siç u tha më lartë, gjithçka konsiderohej si maqedonase, duke filluar nga toka, uji, ajri, qielli, dielli hënë, yjet etj, që "rrezikohen" nga siç thuhej "përvetësimi i popullit jomaqedonas", përkatësisht nga "pakica shqiptare", që sipas tyre përbën rastin e vetëm në botë të kenë dy vende të tyre amë. Në pjesën e dytë të të ashtuquajturit "Libri i peticionit", në pika të shkurta përshkruhet "arsyeshmëria" përkatësisht "qëllimi" i hartimit të atij dokumenti, ku siç do të shohim në vazhdim, në stilin alla-milloshевичane, do të kërkohej marrja e masave të rrepta si nga ana e maqedonasve po ashtu edhe nga vet shteti, për siç thuhej ndërprerjen e politikës "agresive" të shqiptarëve, që në kohë të fundit "po manifestohet gjithnjë e më shpesh në republikë". Këto masa, sipas tyre duhej të ndaheshin në dy pjesë: urgjente dhe afatgjate, përkatësisht, sistematike. Si masa urgjente parashikoheshin moskonstituimi i kuvendeve komunale në pjesën perëndimore të Maqedonisë, për shkak dominimit të deputetëve shqiptarë, përkatësisht të dy partive të atëhershme shqiptare PPD-ë dhe PDP-ë, deri në shpalljen e zgjedhjeve të reja parlamentare dhe e dyta, shqiptarëve të mos u jepet "as çfarë funksioni" përkatësisht "resori" në pushtetin ekzekutiv republikan. Ndërkohë, të vazhdohej me masa tjera, sistematike, afatgjate, përmes së cilave shqiptarët me Kushtetutë të shpallëshin "pakicë nacionale", të pezullohej veprimtaria politike e Partisë për Prosperitet Demokratik dhe Partisë Demokratike Popullore, të mos lejohej përdorimi i flamurit shqiptar, të dëboheshin nga vatrat e tyre, të gjithë ata shqiptarë, të cilët na paskan "zbritur nga qielli" me qëllim të "uzurpimit" të "hapësirës nacionale e territoriale maqedona-



se", si dhe të gjithë ata, veprimtaria e të cilëve na qenka "nacionaliste" dhe "problematike". Përveç kësaj, ata kërkonin që Qeveria e RSM-së, të parasheh arrijtjen e një marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, për shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje për në shtetin shqiptar "ngjashëm si ajo e viteve pesëdhjeta", që Tito e arriti me diplomatin e atëhershëm turk Fuat Kypryli, me ç'rast brenda gjastë viteve qenë dëbuar me dhunë rreth 150.000 shqiptarë. Për këta albanofob e shovinist të tërbuar maqedonas, të gjitha ato masa, kishin karakter "mbrojtës" dhe të njëjtat ishin të "domosdoshme", të "pa shmangura", "urgjente", dhe të "arsyeshme" historikisht, për arsye siç thuhej në pjesën e fundit të dokumentit "këta mysafir të pa ftuar nga bota islame", nuk kanë dëshmuar dhe nuk do të dëshmojnë asnjëherë për një jetesë të përbashkët me krishterët".

Në rrethana, kur të drejtat e shqiptarëve sa vinin e ngushtoheshin, njëra ndër dy partitë e atëhershme shqiptare, Partia Demokratike Popullore (PDP-ë), doli me një deklaratë politike e cila më 19 qershor të vitit 1991, u botua në gazetën "Nova Makedonija". Në pikën dy (2) të saj thuhej:

"PDP është përcaktuar që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'i pranohet statusi i kombit (janë mbi 3 milion) edhe atë si shprehje e lirisë dhe të drejtës për përcaktim të lirë nacional, për vetëvendosje dhe me të drejtë të shkëputjes nga robëria totalitare e asimiluese pan-sllaviste".

Një qëndrim i tillë i PDP-së, thuhej në vazhdim të deklaratës, vjen si rrjedhojë e refuzimit të kërkesave të parreshtura të shqiptarëve nga udhëheqja e atëhershme maqedonase, e cila "në vend të progresit e zgjedhi regresin", dhe si rrjedhojë janë bërë dhe po bëhen shumë reduktime e ndalime për shkollim në gjuhën shqipe, "janë miratuar ligje diskriminuese në fushën e shkollimit, u mbyllën shumë shkolla të mesme në gjuhën shqipe, na urdhëruan të mësojmë në 'paralelet e përziera', administratën pedagogjike ta udhëheqim në gjuhë të huaj, sollën vendime për shkollim të mesëm të imponuar vetëm në gjuhën maqedonase, kërkesat gjithshqiptare për mësim në gjuhën shqipe injorohen nga 'shteti demokratik', pasiviteti shtetëror, që i përket shkollimit në gjuhën shqipe, paraqet një politikë aktive të denacionalizimit dhe asimilimit të kombit shqiptar...etj."

Deklarata Politike e PDP-së nxiti qarqet e atëhershme shoviniste maqedonase, të involvuar brenda të ashtuquajturës "qeveri të ekspertëve" (në të cilën pa dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve, merrnin pjesë edhe tre shqiptarë), të ndërmarrin masa ndëshkuese kundër popullsisë shqiptare në përgjithësi, e të aktivistëve të kësaj partie në veçanti. Ministria për Informim përmes një komunikatë të lëshuar më 27 qershor, Deklaratën e PDP-së, e kualifikoi si një "pamflet" që çon, siç thuhet "kah destabilizimi i Republikës, kah cenimi i marrëdhënieve ndërnacionale...", krejt kjo "me qëllim të arritjes së funksionit të shkëputjes së pjesëve nga Maqedonia dhe krijimin e një fiksioni për Shqipëri të madhe".

Ndërkohë, edhe Partia për Prosperitet Demokratik më datë 29 korrik 1991, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë i dorëzoi "Deklaratën për statusin e barabartë të shqiptarëve në Maqedoni". Sipas saj bartës të sovranitetit duhej të ishin të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, ndërsa gjuhë nacionale të shpallëshin maqedonishtja, shqipja dhe turqishtja. Më tej thuhej se Republika e Maqedonisë duhet të ndërtoj mekanizma kushtetuese përmes së cilave do të garantohet barazia nacionale, pranë së cilave për të gjitha çështjet të cilat u përkasin marrëdhënieve ndërnacionale duhet të vendoset me konsensus. Në pikën nëntë të deklaratës bëhej me dije se: "Shqiptarët në Republikën e Maqedonisë kanë të drejtë të vendosin për fatin e tyre dhe në këtë kontekst ta bartin pjesën e tyre të përgjegjësisë për fatin e Republikës". Ngjashëm sikurse e para, edhe kjo Deklaratë u hodh poshtë nga Qeveria e RSM-së, me arsyetimin se "statusi i kolektiviteteve nacionale, pakicave nacionale dhe etnike dhe pjesëtarëve të kombeve tjera" do të definohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

(vijon në numrin e ardhshëm)

KOSOVË - SHQIPËRI, TEST I RËNDËSISHËM PËR DY EKIPIET SHQIPTARE

Shqipëria dhe Kosova do të zhvillojnë vëllazëroren e radhës, por këtë herë në Zvicër, sot (e martë) në orën 20:00. Si trajneri ashtu edhe futbollistët e Kosovës, ndeshjen kundër Shqipërisë, e shohin si test të mirë për ndeshjet që përfaqësuesja i luan në shtator në Ligën e Kombeve të UEFA-s

Në qytetin e bukur të Cyrihut, dy Përfaqësueset shqiptare, Kosova dhe Shqipëria do ta luajnë një ndeshje miqësore. Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës, Bernard Shallandes ka folur për mikrofonat e "Supersport" duke i shpalosur synimet e tija. "Detyra ime është të punoj dhe të përgatis ekipin për ndeshjen kundër Shqipërisë dhe për të qenë gati në muajin shtator. Nuk kemi shumë ndryshime. Është mirë që lojtarët t'i kemi të gjithë për tu përgatitur sa më mirë në muajin shtator. Do t'ia jap mundësinë të gjithë futbollistëve", ka thënë Shallandes. Sipas trajnerit zviceran synimi është të përgatiten sa më mirë për ndeshjen ndaj Azerbajxhanit. "Është shumë interesante. Për mua jam trajner. Shqipëria është skuadër shumë e fortë, por për mua e rëndësishme është të përgatitemi kundër Azer-



bajxhanit në muajin shtator. Gjithsesi kam dëshirë ta fitoj këtë ndeshje", deklaroi Shallandes. Derisa, Bernard Berisha, mesfushori me tipare sulmuese i Kosovës është shprehur optimist për një ndeshje të bukur dhe plot argëtim për të pranishmit. "Do të jetë një ndeshje si gjithë të tjerat, që do t'i shërbejë trajnerit për të parë gjendjen e lojtarëve. Një ndeshje pa ndonjë rëndësi të veçantë dhe secili ekip do të përpiqet të fitojë. E rëndësishme është që të pranishmit të kënaqen. Si ndaj Shqipërisë, ashtu edhe ndaj çdo kundërshtari tjetër, duhet dhënë maksimumi në fushë për Kosovën. Nëse vjen në ekipin kombëtar me dëshirë, atëherë gjërat shkojnë mirë.

Ne po përgatitemi për të dhënë gjithçka në këto ndeshje miqësore që kemi në program", ka thënë Berisha. Ndërkohë, për sfidën me Kosovën por edhe atë me Ukrainën ka folur sulmuesi Sokol Cikalleshi. "Ndeshja e parë me Kosovën është disi më interesante, konsiderohet vëllazërore, por do të jetë e luftuar në fushë. Edhe atmosfera në tribunë do të jetë shumë e bukur. Uroj të marrim rezultat pozitiv. Pastaj kemi Ukrainën, ekip disi më i fortë. Jemi ndeshur me këtë skuadër para Evropianit dhe na mundi. Duhet t'i bëjmë gjërat më ndryshe këtë herë. Do të jetë test i mirë për trajnerin dhe lojtarët, për të parë se ku jemi", deklaroi Cikalleshi.

TIFOZËT TURQE PUSHTOJNË "INSTAGRAMIN" E SHAQIRIT

Eja në Gallatasaraj

Xherdan Shaqiri është bërë njëri nga futbollistët më të kërkuar në Evropë. Rënia e Stok Sitit nga elita e futbollit anglez kaq bërë që interesimi për Shaqirin nga skuadrat evropiane të jetë i madh. Së fundmi garës për transferimin e Shaqirit iu ka bashkuar edhe kampioni i ri turk Gallatasaraj. Gjiganti turk është i gatshëm të paguajë klauzolën e Xherdanit e cila është 14,5 milionë euro. Me të marrë lajmin se Shaqiri mund të transferohet në Gallatasaraj, tifozët verdhë e kuq kanë marrë një iniciativë unike. Tifozët turq të Gallatasarajit, kanë pushtuar "Instagramin" e Xherdanit duke i shkruar 'Eja në Galatasaray'. Në fotot e fundit të Shaqirit në rrjetin social "Instagram" janë bërë mijëra komente të




njëta nga tifozët turq. Mbetet të shihet nëse Shaqiri do ta marrë parasysh dëshirën e madhe të tifozëve të Gallatasarajit për tu transferuar në Stamboll. Të njëjtën gjë e kishin bërë edhe tifozët e Beshiktashit me sulmuesin spanjoll Diego

Kostas duke i kërkuar transferimin te klubi bardh e zi. Por në fund Kosta kishte zgjedhur të rikthehej në Spanjë te Atletico Madrid. Për Shaqirin interesim kanë shprehur edhe skuadrat angleze si Njukasëll, Everton, Sautempton.



FEDERER SHPALOS DËSHIRËN E TIJ PARA TËRHEQJES

DUA TË LUAJ EDHE NJË HERË NË ROLAND GARROS



“Nëse dua të luaj sa më gjatë më duhet të marr disa vendime dhe programoj me kujdes kalendarin, pasi kam edhe një familje. Por dua që të luaj në Roland Garros edhe një herë tjetër në karrierën time para se të tërhiqem nga sporti dhe të dueloj aty me Nadal”, pohon Federer

Të hënën filloi grand slemi i Roland Garros në tenis, ndërsa për të dytin vit me radhë do të mungojë zvicerani Rogjer Federer, që për shkak të vështirësive që ka në fushat me dhe, ka vendosur ashtu si vjet të mos luajë asnjë ndeshje në këtë sipërfaqe. Federer përgatitet për t'u

rikthyer pas dy muajsh pushin në fushat me bar. Duke folur për turneun parisien, të cilin Federer e ka fituar vetëm një herë në karrierën e tij (vitin 2009), zvicerani shprehet: “Klasifikimi nuk kushtëzon lojën time dhe turnetë ku marr pjesë. Kam punuar shumë për t'u rikthyer “numri 1”, por

në këtë moshë (36 vjeç) nuk është objekti im të gjurmtoj kreun”, tha Federer, aktualisht i dyti në botë. Federer shprehet se mbi të gjitha rëndësi ka shëndeti, të jetë në formë dhe të ketë mundësi të luajë sa më gjatë. “Unë besoj se Nadal është sërish favorit në Roland Garros. Të luaj kundër tij në gjithë këto vite ka qenë e jashtëzakonshme, më ka shtyrë përpara për të qenë më i fortë dhe përmirësoj lojën time”, tha zvicerani, që shpreson që një ditë të përballet sërish me rivalin spanjoll në këtë sipërfaqe. “Nëse dua të luaj sa më gjatë më duhet të marr disa vendime dhe programoj me kujdes kalendarin, pasi kam edhe një familje. Por dua që të luaj në Roland Garros edhe një herë tjetër në karrierën time para se të tërhiqem nga sporti dhe të dueloj aty me Nadal”, deklaroi Federer.

Gati të dueloj ndaj Xhoshua në Britani, por me një kusht

Duket se Britania e Madhe do të jetë vendi ku do të përcaktohet kampioni i padiskutueshëm i botës në peshat e rënda në boks. Amerikani Deontaj Vilder ka rënë dakord që të duelojë ndaj Entoni Xhoshua në vendlindjen e këtij të fundit, në një përballje që do të unifikojë titujt kampionë bote në këtë kategori. Por Vilder, kampion i kategorisë “WBC”, ka një kusht që të kalojë oqeanin për të ardhur dhe dueluar në Londër. Ai nuk do të ngjitet në ring në rast se Joshua nuk i garanton një fitim prej 20-30 milionë dollarësh. Kjo është një shumë më e vogël se ajo që Vilder i ofroi Xhoshuas për të dueluar në Amerikë, një muaj më parë. “Ne i ofruam 50 milionë dollarë. Ai do të bëhej bokseri i parë që do të merrte 50 milionë në histori. Ishte diçka e lehtë për të gjithë, që ai të vinte dhe të duelonte në Amerikë, do të ishte një sfidë e çmendur. Tani duan që të duelojnë në Britaninë e Madhe. Jam dakord, por Xhoshua duhet të më ofrojë të paktën 20 milionë dollarë që të vij aty”, u shpreh Vilder, duke shtuar se kjo sfidë do të zhvillohet pas muajit shtator.



ENGJITI PARMËN NË SERIE A

Lukarelli i jep fund karrierës

Kapiteni i Parmës, Alessandro Lukarelli është larguar nga futbolli, duke i dhënë kështu fund karrierës së tij si futbollistë. 40 vjeçari i cili ka një karrierë fantastike dhe dha kontributin e tij më të madh në futboll, kryesisht tek ekipi i Parma-s, të cilën nuk e la vetëm në kategorinë D po udhëtoi me të, duke e ringjitur përsëri në Serie A. Ai ka luajtur 10 vjet në krahët e Parma-s ku ka zhvilluar 333 ndeshje. Si kapiten nuk e braktisi ekipin, kur falimentoi dhe ra në kategorinë D, por dha maksimumin e tij për ta rikthyer në elitën e futbollit italian. Në festën që u organizua në nder të ringritjes së klubit në Serie A, Lukarelli i ka dhënë lamtumirë futbollit duke thënë: “Unë e kam përqaftuar Parmën për 10 vjet duke dhënë gjithçka. Tani që jemi kthyer në Serie A, qëllimi është arritur”, deklaroi Lukarelli.



RIKIARDO FITON GARËN E ÇMIMIT TË MADH TË MONTEKARLOS

Kisha dy vjet që e prisja këtë moment

Daniel Rikiardo me “Red Bull” fitoi garën e Çmimit të Madh të Montekarlos, një garë e mërzhitshme dhe pa surpriza, me pilotët e kreut që ruajtën pozicionet e tyre. Në podium u ngjiten edhe Sebastian Fettel me Ferrari (i dyti) e Luis Hamilton me Mercedes (i treti), ndërkohë që pas tyre u renditën dy pilotët finlandezë Kimi Raikkonen (Ferrari) me Valtteri Bottas (Mercedes). Pra, pesë të parët ruajtën pozicionet që kishin para se të niste gara, deri diku e pritshme në një pistë qytetase si ajo e Montekarlos, që ndryshe nga vitet e fundit, këtë herë nuk dhuroi shumë surprizë apo emocione. Pilotët garuan brenda limiteve, evituan në maksimum gabimet dhe ndalesat në bokse për të ndryshuar gomat nuk sollën asnjë surprizë në renditje. Ndryshe, për Rikiardo ky është suksesi i dytë në këtë Botëror, pas atij në Azerbajxhan, duke barazuar 2 fitoret e Fettel dhe dy të Hamilton,



duke hyrë kështu në garë për titullin kampion. Një fundjavë e përkryer për Red Bull, që tregoi se është pretendente. I emocionuar dhe plot me gëzim! Daniel Rikiardo ka komentuar në këtë mënyrë triumfin në Çmimin e Madh të Montekarlo: “Ndjej shumë emocione. Kishe dy vjet që ishte përgatitur për këtë sukses dhe më në fund erdhi. Kemi pasur probleme dhe nuk kam kaluar një periudhë të mirë. Në një lloj pikë

nisëm të humbasim fuqi dhe mendova se gjithçka do të ishte e kotë, sepse Fettel nuk largohej, por mbërrita në finish duke përdorur marshin e gjashtë. Falënderoj skuderinë. Mu desh të administroja shumë faktorë, por fituam në një pistë historike si është Montekarlo dhe është diçka shumë e bukur. Pashë flamuj të Australisë në pistë dhe i falënderoj për mbështetjen”, tha pas garës Rikiardo.

Sallah gëzon egjiptianët

Edhe pse pësoi një dëmtim serioz në shpatull, Mohamed Sallah nuk dorëzohet dhe pavarësisht se mediat e japin si të sigurt mungesën e tij në Botërorin rus, sulmuesi i Liverpoolit ka bindjen se do të jetë në kompeticionin më të rëndësishëm në rang kombëtarësh. Sallah me një mesazh në “Twitter” ka lumturuar pa masë të gjithë tifozët egjiptianë të cilët dëshirojnë ta shikojnë me çdo kusht me fanellën e ekipit përfaqësues “fa-

raonin” e tyre. “Ishte një natë shumë e vështirë por unë jam një luftëtar. Pavarësisht probabilitetit, unë jam besimplot se do të jem në Rusi për t’iu bërë të gjithëve të ndiheni të lumtur. Dashuria dhe juaj do të më japin forcën e duhur për të cilën kam nevojë”, shkruan Sallah në “Twitter”. Edhe përplasja me Ramos ishte shumë e fortë në Egjipt besojnë se do të kenë në dispozicion idhullin e tyre për Botërorin rus.



KRISTIANO RONALDO QETËSON TIPOZËT E REAL MADRIDIT

Shihemi sezonin e ardhshëm

Duke folur para mijëra mbështetësve të mbledhur në kryeqytet, ndërsa Real Madridi festoi triumfin e tretë radhazi në Çampions, ylli portugez sugjeroi se mund të vazhdonte në "Bernabeu" edhe për të paktën një vit tjetër

Kristiano Ronaldo u shfaq për të ofruar shpresë për tifozët e Real Madridit, se ai do të qëndrojë në klub. Këtë e bëri gjatë paradës së trofeut të Ligës së Kampionëve, të dielën. 33-vjeçari ishte në hije gjatë fitores 3-1 ndaj Liverpoolit, në Kiev, ndërsa lëshoi bombën, duke nënkuptuar se do ta linte Real Madridin. Pak më vonë kërkoi falje për kohën e komenteve të tij, pasi thuhet se ishte qortuar privatisht nga kapiteni Sergio Ramos, duke shtuar se do të jepte pak qartësi për të ardhmen e tij në ditët e ardhshme. Megjithatë, duke folur para mijëra mbështetësve të mbledhur në kryeqytet, ndërsa Real Madridi festoi triumfin e tretë radhazi në Çampions, ylli portugez sugjeroi se mund të vazhdonte në "Bernabeu" edhe për të paktën një vit tjetër. "Faleminderit që keni qenë këtu, këtë pasdite", –



tha Ronaldo nga ballkoni i selisë së bashkësisë në "Puerta del Sol". – Kemi falënderuar historinë për ju, që na keni mbështetur gjithmonë. Është një moment i lumtur dhe ne jemi shumë të gëzuar. Hala Madrid dhe asgjë tjetër! Faleminderit djem... Deri sezonin e ardhshëm", tha portugezi. Derisa, gjatë festimeve, lojtarët dhe tifozët e Real Madridit u bashkuan duke thirrur në kor: "Kristiano, qëndro", me Ronaldon duke iu përgjigjur pozitivisht kërkesave. Ai shtoi: "Çfarë mund të them për

këto tifozë, që më japin kaq shumë dashuri çdo ditë? Unë jam shumë krenar për të luajtur në klubin më të madh në botë, faleminderit për këngën, kjo është shumë e rëndësishme për mua. Jam shumë i kënaqur me pasionin tuaj, me këta lojtarë dhe me këta trajnerë, që më japin motivimin më të mirë. Ajo që më pëlqen më së shumti është të fitoj. Me këta lojtarë është e pamundur të mos fitosh Ligën e Kampionëve. Faleminderit shumë!", deklaroi Kristiano Ronaldo.

Junajted do të paguajë 105 mln euro për Milinkoviç-Saviç

Mançester Junajted ka bërë një ofertë prej 105 milionë eurosh për të marrë "yllin" e Lacios, Sergej Milinkoviç-Saviç dhe me shumë gjasa ai do të bëhet futbollisti më i shtrenjtë i blerë ndonjëherë nga Junajted dhe më i shtrenjti i shitur nga Lacio. "Djajtë" e kanë ndjekur prej kohësh serbin dhe tani kanë vendosur të ndërhyjnë duke paguar çekun me 105 milionë, për të mposhtur konkurrencën e Paris Sen-Zhermen, Juventus dhe ndoshta Barcelonës, që po has vështirësi në blerjen e Antonie Grizmann. Murinjo ka ndërmend të luajë me tre mesfushorë qendre në sezonin e ardhshëm dhe njëri prej tyre do të jetë Matiç, tjetri Pogba, për të tretin është gati investimi i madh për Milinkoviç-Saviç. Gjithsesi, duhet edhe alternativa të tjera, pasi ka mbetur vetëm Ander Herrera, sepse Karrik u tërhoq nga futbolli, ndërsa Fellaini do të largohet. Kjo është arsyeja përse Junajted po përgatitet të paguajë 60 milionë euro për Fred të Shakhtar.



Interi dhe Ikardi do të diskutojnë rinovimin e kontratës

Pas shumë thashethesh, është raportuar se Interi do të takohet me Mauro Ikardin dhe agjentin e tij brenda javës së ardhshme për të diskutuar rreth rinovimit të kontratës. Sulmuesi ka klauzolë prej 110 milionë euro në kontratën e tij, por që është e vendosur vetëm për klubet e huaja në dy javët e para të korrikut. Trajneri

Luçiano Spalletti ka thënë se kapiteni zikaltër mund të largohet nëse vjen ndonjë ofertë e mirë, por argjentina nuk ka dhënë ende ndonjë indikacion se dëshiron aventurë të re. Tani Premium Sport, raporton se në java e ardhshme do të jetë vendimtare për të ardhmen e Ikardit pasi klubit do takohet me lojtarin dhe gruan e tij Vanda

Nara, e cila është edhe agjente. Klauzola pritet të rritet, ndërsa gjithashtu edhe rroga e lojtarit. Me bonuse ajo pritet të shkojë në sezon deri në 7.5 milionë euro, një shifër mjaft e lartë për futbollin italian. Vlen të theksohet se Ikardi së bashku me Çiro Immobilen me nga 29 gola kanë qenë golashënuesit më të mirë.

Ançelotti e kërkon Sançezin

Renato Sançez nuk ka kaluar një vit të mirë si huazim te Svonsi në elitën e futbollit anglez. Mesfushori i talentuar portugez humbi hapësirat te Bajernit dhe gjiganti gjerman vendosi ta huazojë në Svonsi. Por portugezi nuk arriti të tregojë asgjë në futbollin anglez duke luajtur në vetëm 12 takime. Një mundësi tjetër ka ardhur për Sançezin që të

vazhdojë të luaj në nivele të larta. Mediat italiane kanë raportuar se Karlo Ançelotti po kërkon t'ia shpëtojë karrierën lojtarit e cila është në rënie të lirë. Ish-trajneri i Bajernit po kërkon transferimin e portugezit në Serie A për t'ia dhënë një fanellë titullari. Napoli është gati të shpenzojë 20 milionë euro për të bindur Bajernin të heqë dorë nga 20 vjeçari.



ri. Gjithsesi në garë për lojtarin mbetet edhe Monaco në Ligue 1 si dhe Benfika në Portugal.

JAJME SHKURT

Fabregas dhurata e Valencias për Çampionsin

Aventura e Cesk Fabregas te Çellsin është drejt mbylljes dhe destinacioni i radhës do të jetë Spanja aty ku u formua edhe si lojtar. 31-vjeçari ka edhe një vit kontratë me "Blutë e Londrës" dhe vetëm një veto e trajnerit të ardhshëm të ekipit mund të pengojë largimin e tij ndërsa Valencia e Villarreal po fërkojnë duart për fantazistin. Ekipi i Marselinon është ai më shumë i interesuar duke parë se luan edhe në "Champions League" dhe Fabregas do të ishte dhurata më e mirë për tifozët e skuadrës.

Oblak dhe Alisson dëshirat e Klopp

Pas natës horror të Loris Karius në finalen e Kievit, te Liverpooli e kanë ndarë mendjen për të gjetur një portier të për sezonin e ardhshëm.

Klubi anglez ka disa alternativa në listë dhe që të gjithë janë me çmim të kripur duke nisur nga Jan Oblak për të cilin Atletico Madrid kërkon të paktën 50 milionë euro. Gjithashtu në listë është edhe Alisson, braziliani i Romës që kërkohet edhe nga Real Madridi, ndërsa në fund është Donnarumma tek i cili mund të afrohen me një ofertë të paktën prej 40 milionë euro.

Dalbert i sakrifikuari i parë i Interit

De Vrij, Asamoah e Lautaro Martinez janë goditjet e Interit deri tani në merkato dhe në pritje për të kompletuar ekipin për Spalettin, Ausilio mendon te shesë një lojtar të paktën para 30 qershorit. Për të mos sakrifikuar një "top player", drejtori sportiv zikaltër po studion ofertat që janë ardhur në drejtim të Dalbert nga Franca, ku Marsej e Monako mendojnë seriozisht për brazilianin. Mbrojtësi nuk dha atë që pritej në sezonin e parë dhe mund të largohet por jo për një ofertë më të ulët se 16 milion euro. Së fundmi në adresë të Interit për brazilianin, ka ardhur një ofertë nga Roma që e do në formë huazimi lojtarin.

Sokratis drejt shitjes

Pasi zyrtarizuan trajnerin e ri që do të jetë Lucien Favre, drejtuesit e Borussia Dortmund po tregohen aktivë në merkato. Goditja e radhës do të jetë afrimi i mesfushorit Marius Volf nga A인트라ht Frankfurt për afro 7 milionë euro ndërsa janë afër akordit edhe me Arsenal për mbrojtësin Sokratis. Ky i fundit ka edhe një vit kontratë me verdhezinjtë dhe për klubin është mundësia e fundit për të mos e humbur me parametër zero ndaj dhe kanë refuzuar ofertën prej 15 milion euro nga Arsenal duke pretenduar 18 milion euro.

Futbolli jep, por edhe merr. Kjo vlen edhe për vendin në lavdi. Historitë e portierëve, në këtë aspekt nuk mungojnë. Edhe pse e ardhmja e Karius duket e shënuar, nuk është e thënë se nuk mund të rilindë dhe të harrojë, gjithnjë nëse mundet, atë të ndodhi në Kiev

Loris Karius nuk do të harrojë kurrë gabimet në Kiev, por nuk është e thënë se karriera e tij ka marrë fund. Por ndoshta edhe gjithçka ka mbaruar. Futbolli ndonjëherë fal, por ndonjëherë një "gafë" mund të sjellë fundin e karrierës. "Gafa" që kushtojnë vendin e punës. Kan i ka thënë Karius se më e keqja duhet ende të vijë. Të gjithë do të kujtojnë gjithmonë atë që ai bëri në Kiev, edhe nëse do të luajë shumë mirë në vitet e ardhshme. Një dënim? Futbolli jep, por edhe merr. Kjo vlen edhe për vendin në lavdi. Historitë e portierëve, në këtë aspekt nuk mungojnë. Edhe pse e ardhmja e Karius duket e shënuar, nuk është e thënë se nuk mund të rilindë dhe të harrojë, gjithnjë nëse mundet, atë të ndodhi në Kiev.

VAN DER SAR

Edvin Van Der Sar ishte fajtori kryesor për dy titujt e humbur nga Juventusit në dëm të Roma dhe Lazio, sidomos në sezonin 2000/01 me dy gafat që bëri holandezi në sfidën direkt ndaj Lacios. Largimi i portierit holandez ishte i pashmangshëm. Por ai pati hakmarrjen e tij, rilindi te Manchester Junajtedi dhe fitoi "Champions League", si një nga protagonistët kryesorë të triumfit në Moskë kundër Çellsit.

LEHMAN

Portieri gjerman mbërriti te Milani në vitin 1998 për të zëvendësuar Sebastiano Rossi, por shumë shpejt nisi të kontestohet nga tifozët kuqezi. Shumë prej tyre do të mbajnë mend akoma gabimin në humbjen 1-3 ndaj Fiorentina. Gabon fatalisht në golin e parë të Batistutas, më pas prek me dorë topin e ardhur nga Kostakurta dhe "Batigol" nuk e fal me një goditje dënimi brenda zonës. Në Serie A mori fund, por rilind në Bundesliga, ku shkëlqen me Dortmundin dhe fiton titullin. Më pas, vazhdoi të shkëlqente deri në fund të karrierës me Arsenalin.

ANTONIOLI

Përvoja e tij te Roma dhe Milani ishte e pafat. Portieri bëri disa "gafa" që i kushtuan vendin e punës. I paharrueshëm është gabimi në derbin e Milanos kur pësoi gol nga 40 metra, nga një goditje pa pretendime e De Agositini. Te Roma fitoi titullin kampion në vitin 2001, por bëri gjithçka për t'ia vështrësuar punën skuadrës së Ka-

KUR "GAFAT" TË KUSHTOJNË VENDIN E PUNËS!



pellos duke pësuar gola qesharak ndaj Perugjës dhe Napolit. Eliminimi nga "Champions League" ishte vetëm faji i tij me dy golat e pësuar ndaj Ajaksit, ku as vetë De Jong dhe Ibrahimoviç nuk e kuptuan si arritën të shënojnë. Ishte fundi i karrierës së tij.

GOIKOÇEA

Vetëm emrin ka të ngjashëm me argjentinasi Goikoçea që e ndihmoi skuadrën e Maradonas të shkonte deri në finalen e "Itali '90". Në sezoni 2012/13, me dëshirën e Zeman, uruguaiani bëhet portieri i

Romës dhe gjithçka ishte një tragjedi. I aftë në lojën në këmbë, por aspak me atë me duar, ku duket se i kishte prej "gjalpi". Kurioz ishte goli i pësuar nga Kaljari, kur e futi vetë topin në rrjetë, edhe pse po dilte jashtë. Ai sezon shkatërrimtar që bëri me Romën praktikisht i

mbylli karrierën, sepse që atëherë nuk është parë më kurrë në futbollin e niveleve të larta.

KOPPOLA

Një tjetër portier që rrezikoi fundin e karrierës, si pasojë e zgjedhjeve të Zeman. Në vitin 2000, Ferdinando Koppola është portieri premtues i të rinjve të Napoli. Trajner çek e mori në ekipin e parë dhe debutimi i tij ishte një makth, një ditë e tmerrshme, me pesë gola të pësuar ndaj Bolonjës. Pas ndeshjes duke qarë tha: "Më shkatërruar karrierën." Vazhdoi të luante futboll në Serie A me Askolin, Regjinën, Sienën, Atalantan, Bolonjën dhe Veronën, por kurrë nuk u bë ai portier i madh që mendohet se do të ishte.



Çamçakëzi vërteton nëse keni apo jo kancer!

A është e mundur që çamçakëzi të vërtetojë nëse keni kancer apo jo? Kjo është plotësisht e mundur pasi tashmë përtpypja e çamçakëzit zëvendëson testin e gjakut, sepse ky produkt absorbon komponimet e lëshuara nga kanceri në pështymë. E gjitha kjo është zbuluar nga një kompani bio-teknike, ku sipas saj, gjatë përtpypjes së çamçakëzit, në pështymë gjenden disa lëndë të quajtura "të paqëndrueshme", të cilat janë komponime kimike të lëshuara nga kanceri. Pas përtpypjes përgjatë 15 minutave, merret në analizë produkti për të parë nëse është apo jo i prekur nga kanceri. Nga kërkimet e bëra nga shkencëtarët e Alabama-s, janë zbuluar lloje të ndryshme çamçakëzesh të cilët zbulojnë kancerin



pankreatik, kancerin e mushkërisë dhe kancerin e gjirit. E vërteta është se tashmë testet e gjakut, biopsitë apo aplikimet e ndryshme për zbulimin e kancerit do të zëvendësohen lehtësisht me çamçakëzin.

**Çdo vit,
5.4 milionë persona
në botë pickohen
nga gjarpërinjtë**



Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), çdo vit 5.4 milionë persona në botë pickohen nga gjarpërinjtë. Po sipas kësaj organizate, çdo vit 138 mijë persona nga e gjithë bota humbin jetën nga gjarpërinjtë dhe 400 mijë të tjerë mbeten me aftësi të kufizuara. Sipas të dhënave, gjysma e rasteve që rezultojnë me vdekje ndodhin në Indi. Ndërsa si arsye e numrit të madh të nivelit të vdekjeve në Indi llogaritet të jetë mungesa në ndërhyrjet emergjente dhe në shërbimet e përgjithshme shëndetësore.

Marokenët, shqiptarët dhe turqit fitojnë më së shumti shtetësinë evropiane

Marokenët, shqiptarët dhe turqit janë qytetarët kryesorë që e kanë fituar shtetësinë e një vendi të Bashkimit Evropian në vitin 2017: me 10.2% marokenet, përkatësisht, 5.7% shqiptarët dhe 4.2% turqit. Sipas EUROSTAT-it, agjencia statistikore e Bashkimit Evropian, 840.000 persona kanë fituar në vitin 2017 shtetësinë e një shteti anëtar të BE-së, kundër 890.000 në vitin 2016 dhe 980.000 në vitin 2015. Mbi 86.000 marokenë janë bërë evropianë dhe 88% prej tyre kanë zgjedhur shtetësinë italiane, spanjolle ose franceze. Prej 48.400 shqiptarëve që e kanë zgjedhur shtetësinë evropiane, 96% janë bërë italianë ose grekë. Ndërsa për turqit, nga 35.000 turq të rinj evropianë, 56% kanë fituar shtetësinë gjermane. Shkalla më e lartë e natyralizimit gjendet në Suedi (6.7 shtetësi, të dhë-



na për 100 të banorë të huaj) dhe Portugali (5.2). Që nga viti 2012, më shumë se pesë milionë njerëz kanë fituar shtetësinë e një shteti anëtar të Bashkimit Evropian. 87% nuk ishin qytetarë të Bashkimit Evropian.

Lë nusen 15 minuta pas martesës, vjehri i kërkoi paratë në zyrën e kurorëzimit

Një dhëndër u nda nga nusja e tij vetëm 15 minuta pas ceremonisë së dasmës, dhe kjo pasi ai "u ndje i ofenduar" nga babai i saj për çmimin e kërkuar. Burri pranoi ti paguante vjehrit të tij 20 mijë paund për dasmën në Dubai, por i moshuari ishte i paduruar të merrte paratë. Anëtarët e familjes dhe miqtë shoqëruan çiftin në zyrën e gjyqarit Sharia për të dëshmuar se kontrata e martesës ishte firmosur. Dhëndri i kishte paguar 10 mijë dollarë në moment, siç dhe ishte rënë dakord, dhe pjesën tjetër pas festës pasi u largua nga ndërtesa e Gjykatës, raporton Gulf News.

Por, babai i donte paratë sa më shpejt, sapo të niste nënshkrimin, dhe pse dhëndri nuk i kishte paratë me vete. Ai i tha se i duhen pesë minuta sa të shkonte te makina e parkuar jashtë dhe të merrte pjesën e mbetur të çmimit të nuses. Por në vend ta lejonte të shkonte, vjehri këmbëngulte të paguante aty në moment, ose të dër-



gonte ndonjë mik a të afërm të merrte paratë. Por dhëndri u ndje i fyer nga kjo kërkesë dhe hoqi dorë menjëherë nga martesja, tha një avokat që po merrej me çështjen. "Ai i tha babait të nuses se nuk do të donte që vajza e tij, si bashkëshortja e tij tashmë, të divorcohej në më pak se 15 minuta nga nënshkrimi i kontratës së marte-

sës", tha avokati. Divorci në vetëm 15 minuta është ekstrem, por nuk është rasti i parë në historinë e Emirateve, pasi kanë pas martesja që zgjatë vetëm pak sekonda. Në 2012, dhëndri u largua nga gjykata vetëm pak sekonda pas nënshkrimit, sepse babai i nuses i kërkoi që vajza të mbante punën e saj.

1453 - Bie Konstantinopoja në duart e Muhamedit të II (turqve) dhe me këtë përfundon periudha e Perandorisë së Bizantit.

1692 - Beteja e La Hoxhit: Flotat angleze dhe holandeze mundin flotën franceze.

1727 - Pjetri i II emërohet Car i Rusisë.

1916 - SHBA pushtojnë Republikën Domenikane.

1922 - Ekuadori shpallet shtet i pavarur.

1944 - Trupat britanike pushtojnë Aprilian në Itali.

1979 - Ipeshkvi Abel Muzorewa jep betimin si Kryeministri i parë zezak në Zimbabve

1989 - Studentët protestues në Kinë ndërtojnë replikën e Statujës së Lirisë.

1990 - Boris Yeltsin zgjidhet kryetar i Republikës Ruse.

2001 - Bëhet inaugurimi i Ditës Ndërkombëtare të Paqeruajtësve të OKB.



Humbja e një orë gjumi është e barsvlershme me dy vjet të rritjes së njohurive dhe zhvillimit. Sipas studimeve më të fundit mungesa e gjumit ul nivelin e inteligjencës. Të flet një orë më pak gjumë do të thotë që truri i një personi në klasë të gjashtë kthehet në trurin e një nxënësi në klasë të katërt. "Humbja e një orë gjumi është e barsvlershme me dy vjet të rritjes së njohurive dhe zhvillimit", thonë studimet. Ka një lidhje reciproke midis notave dhe sasisë së gjumit. "Adoleshentët të cilët merrnin 10-she flinin 15 minuta më shumë se sa ata që merrnin 9-she e kështu me radhë". Të dhënat nga Wahlstrom ishin pothuajse përsëritje perfekte e rezultateve nga studimi i më shumë se 2 mijë nxënësve në Rode Island të SHBA-së.

PLAKU DHE TAKSISTI

Njëherë një plak i cili i kishte dy valixhe të rënda në dorë, shkon e pyet një taksist se sa kushtonte për ta dërguar atë deri në vendin e caktuar!

Taksisti i thotë: 10 euro.

Plaku: Po valixhet?!

Taksisti: Valixhet janë pa pagesë.

Plaku ia kthen: Mirë, merri t'i valixhet se unë vij në këmbë!"



Në një zemër që dashuron vërtetë, ose xhelozia vret dashurinë, ose dashuria vret xhelozinë.

(Dostojevski)



KALENDARI HISTORIK 29 MAJ



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS